



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 20/11
Datë: 20.04.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 prill 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Fushën e Kontrollit të Tregtisë me Mallra Strategjike.
2. Obligohen Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit dhe institucionet e tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë , Tregtisë dhe Inovacionit

*Ministarstvo Industrije, Preduzetništva ,Trgovine i Inovacija - Ministry of
Industry, Entrepreneurship ,Trade and Innovationn*

**KONCEPT DOKUMENTI PËR FUSHËN E KONTROLLIT TË TREGTISË ME
MALLRA STRATEGJIKE**

Mars 2026

Përmbajtja

Përmbledhje e koncept dokumentit për fushën e Kontrollit të tregtisë së Mallrave

Strategjike	3
Hyrje	7
Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit	9
Kapitulli 2: Objektivat	21
Kapitulli 3: Opsionet	22
Kapitulli 3.1: Opsioni asnjë ndryshim	24
Kapitulli 3.2: Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit pa ndryshime ligjore	24
Kapitulli 3.3: Opsioni i tretë	25
Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme	31
Kapitulli 4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave	33
Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi	34
Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve	36
Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme	36
Kapitulli 6.2: Tabela e krahasimit me të tre opsionet	40
Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm	42
Kapitulli 7.1. Dispozitat për Monitorim dhe vlerësim	43
Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik	43
Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore	48
Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore	52
Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore	56

Përmbledhje e koncept dokumentit për fushën e Kontrollit të Tregtisë së Mallrave Strategjike

Informacionet e përgjithshme	
Titulli	Koncept Dokumenti për fushën e Kontrollit të Tregtisë me Mallra Strategjike
Ministria bartëse	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit
Personi kontaktues	Zana Kotorri - Drejtore e Departamentit për Kontrollin e Tregtisë me Mallra Strategjike zana.kotorri@rks-gov.net
PKZH 2024-2026	Pjesë e PKZH 2026 – 2028. Qëllimi strategjik: <ul style="list-style-type: none"> - Ndërtimi i një mjedisi për biznes të drejtë, të adaptueshëm dhe konkurrues. Masa strategjike: <ul style="list-style-type: none"> - Përmirësimi i rregullatorit, unifikimi dhe përmirësimi i shërbimeve ndaj biznesit. Aktiviteti: <ul style="list-style-type: none"> - Hartimi dhe miratimi i koncept dokumentit për kontrollin e tregtisë me mallrat strategjike.
Prioriteti strategjik	Ndërlidhja me disa prioritete strategjike të Qeverisë së Republikës së Kosovës Qëllimi strategjik: <ul style="list-style-type: none"> - Ndërtimi i një mjedisi për biznes të drejtë, të adaptueshëm dhe konkurrues. Masa strategjike: <ul style="list-style-type: none"> - Përmirësimi i rregullatorit, unifikimi dhe përmirësimi i shërbimeve ndaj biznesit. Aktiviteti: <ul style="list-style-type: none"> - Hartimi dhe miratimi i koncept dokumentit për kontrollin e tregtisë me mallrat strategjike. <p>1. Plani Kombëtarë për Integrim Evropian 2026-2030</p> <p>Blloku III: Standardet Evropiane – Përafrimi i Legjislacionit të Kosovës me Acquis-në e BE-së.</p> <p>3.30. Kapitulli 30 i acquis-së: Marrëdhëniet me jashtë.</p>

	<p>3.30.2. Koncept Dokumenti për fushën e kontrollit të tregtisë me mallrat strategjike, i miratuar.</p> <p>2. Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025</p> <p>2.8. Industria, ndërmarrësia dhe tregtia;</p> <p>2.8.1 Përmirësimi i mjedisit të të bërit biznes;</p>
Vendimi	
Çështja kryesore	<p>Harmonizimi i Ligjit në fuqi 04/L-198 për Kontrollin e Tregtisë me Mallra Strategjike, komfor ndryshimeve të Rregulloreve dhe ligjeve të BE-së dhe Legjislacionit vendor që ndërlidhet me fushën e kontrollit të mallrave strategjike.</p> <p>Ky dokument rekomandon Opsionin 3 - miratimin e Ligjit të ri për Kontrollin e Tregtisë me Mallra Strategjike, si opsion i preferuar për rritjen e saktësisë dhe efektivitetit të legjislacionit kornizë të Republikës së Kosovës në fushën e kontrollit të tregtisë me mallra strategjike.</p>
Përmbledhje e konsultimeve	<p>1. Janë mbajtur dy takime me ekspertët e BE-së, konkretisht Programit EU P2P, të cilët merren me kontrollin e eksporteve të mallrave me përdorim të dyfishtë , të cilët njëkohësisht janë edhe donatorë të trajnimeve e punëtorive rreth proceseve që ndërlidhen me kontrollin strategjik në BE-, këto janë fonde të cilat ndahen nga KE të dedikuara për vednet e Ballkanit perëndimor.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Z.Sylvian Palie • Znj.Vesna Foht <p>Rekomandimet e tyre renditen si në vijim,</p> <ul style="list-style-type: none"> • Transpozimi i Rregullores së BE-së 2021/82 për vendosjen e një regjimi për kontroll të eksportit, ndërmjetësimit, asistencës teknike , tranzitit dhe transferimit të mallrave me përdorim të dyfishtë të cilat janë riformular. • Përcaktimi i kirtoreve për regjistrim në regjistër, certifikim,licencim , procedurat e inspektimeve të operatorëve ekonomik të cilët merren me tregti të mallrave me përdorim të dyfishtë. • Zbatimi i PBP-së, plotësim ndryshimi i manualit / udhezuesit për certifikim të PBP-ve për koompanitë. • Catch-all kontrolli , të zërthehet detajisht mënyra e aplikimit të ksaj procedure kontrolluese ,të përcaktohen kriteret konkrete të njoftohet dogana me rastin e aplikimit të catch-all kontrollit. <p>2. Janë mbajtur dy takime virtuale /online me ekspertët e BE-së, konkretisht të organizuara dhe mbështetura nga BAFA Gjermane (Zyra Federale për Çështje Ekonomike dhe Kontroll të Eksportit - Gjermani) , lidhur me pjesën e kontrollit të tregtisë me mallra dhe pajisje ushtarake.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Z.Krzysztof Firkowski

- **Znj.Aureliana Neascu**

Po ashtu është mbajtur edhe një punëtori një ditore me ekspertin e kontraktuar nga BAFA –znj. **Aureliana Neascu**

Rekomandimet e tyre renditen si në vijim,

- Transpozimi i Rregullores së BE-së 2021/821,
- Traktati për Tregti të Armëve ;
- Lista e Përbashkët për Mallra dhe Pajisje Ushtarake e Bashkimit Evropian të miratuar nga Këshilli më 19 shkurt 2024) CFSP 2024/C pajisjet e mbuluara nga Pozicioni i Përbashkët i Këshillit 2008/944/CFSP që përcakton rregullat e përbashkëta që rregullojnë kontrollin e eksporteve të teknologjisë dhe pajisjeve ushtarake.
- Qëndrimi i përbashkët i Këshillit të BE-së 2008/944/CFSP 8 dhjetor 2008
- Qëndrimi i përbashkët i BE-së 2003/468/CFSP e 23 qershorit 2003 mbi kontrollin e brokerimit të armëve ;
- Veprimi i përbashkët i Këshillit i datës 22 qershor 2000 lidhur me kontrollin e asistencës teknike në lidhje me disa përdorime ushtarake të fundit etj.
- Përcaktimi i kriterëve për regjistrim në regjistër ,certifikim , licencim ,procedurat e inspektimeve të operatorëve ekonomik të cilët merren me tregti të mallrave dhe pajisjeve ushtarake.
- Inkorporimi i kontrollit të importit dhe eksportit për mallra dhe pajisjet ushtarak , për institucionet e Sigurisë në vend ,referuar praktikave dhe procedurave të BE-se.
- Largimi nga procedurat kontrolluese dhe licencuese të importeve të armëve për përdorim civil .
- Raportimi në UNROCA - UN Register of Conventional Arms

3.Janë përfishirë rekomandimet nga ekspertë e kontraktuara (Securus-Strategic Trade Solutions) nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës , programi EXBS, të cilët kanë bërë rishikimin e Legjislacionit të Republikës së Kosovës rreth sistemit të kontrollit të tregtisë me mallra strategjike , në konsultim dhe diskutim me Dkts.

Në kuadër të kësaj kanë përgatitur materialin me rekomandime rreth harmonizimit të dispozitave ligjore për Kontrollin e Tregtisë Strategjike dhe Sigurisë Kufitare në Republikën e Kosovës.

Rekomandimet renditen si në vijim,

- Transpozimi i Regullorës së BE-së 2021/821 për vendosjen e një regjimi për kontroll të eksportit, ndërmjetësimit, asistencës teknike, tranzitit dhe transferimit të mallrave me përdorim të dyfishtë të cilat janë riformular.
- Zbatimi i Listës së Mallrave me Përdorim të Dyfishtë /EU 2023/2616
- Zbatimi i Listës së Përbashkët për Mallra dhe Pajisje Ushtarake a Bashkimit Evropian të miratuar nga Këshilli më 19 shkurt 2024) CFSP 2024/C pajisjet e mbuluara nga Pozicioni i Përbashkët i Këshillit 2008/944/CFSP që përcakton rregullat e përbashkëta që rregullonë kontrollin e eksporteve të teknologjisë dhe pajisjeve ushtarake

	<ul style="list-style-type: none"> • Zbatimi i Traktatit për Tregti të Armëve. • Qëndrimi i përbashkët i Këshillit të BE-së 2008/944/CFSP 8 dhjetor 2008 . • Qëndrimi i përbashkët i BE-së 2003/468/CFSP e 23 qershorit 2003 mbi kontrollin e brokerimit të armëve. • Veprimi i përbashkët i Këshillit i datës 22 qershor 2000 lidhur me kontrollin e asistencës teknike në lidhje me disa përdorime ushtarake të fundit etj. • Zbatimii i E-licencimit. <p>Konsultime tjera do të zhvillohen gjatë procesit të konsultimit paraprak dhe publik të paraparë me Rregulloren (QRK) 17/2024 e Punës së Qeverisë. Data e fillimi të konsultimit publik është 20.12.2024 deri më 10.01.2025, nuk kemi pranuar komente me shkrim .Bashkangjitur do të jenë raportet e procesit të konsultimeve .</p>
Opsioni i propozuar	Ligji i ri për Kontrollin e Tregtisë me Mallra Strategjike

Ndikimet kryesore të pritshme	
Ndikimet buxhetore	Kosto shtesë në rritjen e numrit te zyrtarëve në DKTMS sepse me stafin ekzistues nuk mund të mbulohen të gjitha aktivitetet e parapara me ligjin e ri. Pjesa e digjitalizimit kërkon kosto shtesë , si dhe punësimi të zyrtarit i cili është i paraparë me strukturë organizative.
Ndikimet ekonomike	Pra ngritët qarkullimi dhe kontrolli i tregtisë të mallrave strategjike e që do të ketë ndikim në rritjen ekonomike dhe buxhetore.
Ndikimet shoqërore	Në informimin e publikut, parandalimin e krimit dhe sigurinë në përgjithësi.
Ndikimet mjedisore	Nuk ka ndikime relevante të pritshme në këtë kategori.
Ndikimet ndër-sektoriale	Nuk ka ndikime relevante të pritshme në këtë kategori.
Ngarkesat administrative për kompanitë	Nuk ka ndikime relevante, sepse eliminohen licencat për import të mallrave ushtarake për përdorim civil, po ashtu eliminohen procedurat e regjistrimit në regjistër për operatorët ekonomik që tregtojnë mallra me përdorim të dyfishtë , digjitalizohet dhe funksionalizohet sistemi i E-licencimit.

Testi i NVM-ve	Nuk është aplikuar Testi i NVM-ve.
----------------	------------------------------------

Hapat e ardhshëm	
Afatshkurtër	Hartimi i Ligjit të ri për Kontrollin e Tregtisë me Mallra Strategjike
Afatmesëm	- Hartimi i akteve nënligjore, - Ngritja profesionale e stafit dhe rritja e numrit të tyre, - Funksionalizimi i sistemit elektronik Stratlink (E-licencimi), lidhur me aplikimi dhe lëshimin e licencave dhe certifikatave për operatorët ekonomik .

Hyrje

Ligji nr.04/L-198 për Kontrollin e Tregtisë me Mallra Strategjike rregullon eksportin, importin, transitin, trans-ngarkimin, ri-eksportin dhe ri-transferimin e mallrave strategjike, ofrimin e shërbimeve të ndërlidhura, si dhe kontrollin, mbikëqyrjen, të drejtat dhe detyrimet e palëve që marrin pjesë në aktivitetet e biznesit nga kjo fushë. Qëllimi i këtij ligji është ta avancojë sigurinë shtetërore dhe interesat e politikës së jashtme të Republikës së Kosovës, drejt përbushjes së detyrimeve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare në lidhje me mospërhapjen e armëve të shkatërrimit në masë dhe mallrave tjera strategjike të shfrytëzuara për qëllime ushtarake dhe t'i kontribuojë përpjekjeve ndërkombëtare dhe rajonale për rregullimin e tregtisë me mallrat strategjike.

Dispozitat e këtij ligji zbatohen ndaj secilit person fizik ose juridik në territorin e Republikës së Kosovës, duke përfshirë të gjitha zonat e lira tregtare, zonat e lira doganore, dhe hapësirën ajrore; secilit shtetas të Republikës së Kosovës, brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës; secilit person juridik i cili në Republikën e Kosovës e ka të regjistruar zyrën, selinë ose veprimtarinë e përhershme të biznesit, si dhe zyrat përfaqësuese ose filiale të personit në vendin e huaj; secilit person të huaj, i cili gjendet jashtë territorit të Republikës Kosovës dhe që operon në emër ose nën kontrollin e personit nga Republika e Kosovës.

Ministria e Industrisë, Ndërmarrsisë dhe Tregtisë, respektivisht Departamenti për Kontrollin e Tregtisë me Mallra Strategjike është përgjegjës për hartimin e Koncept Dokumentit dhe kornizës ligjore për Mallra Strategjike. Me datë 05.02.2024 me nr.Protokoli 575/02 zv.Sekretari i Përgjithshëm i MINT ka formuar grupin punues për hartimin e draftit fillestar të Koncept Dokumentit për kontrollin e tregtisë me mallra strategjike.

Bazuar në Udhëzuesin dhe doracakun për hartimin e Koncept dokumentit, Departamentin për kontrollin e tregtisë me mallra strategjike, në bashkëpunim me ministritë relevante dhe palët e interesit, është arritur në përfundim se Ligji nr.04/L-198 për Tregtinë e Mallrave Strategjike ka nevojë për ndryshime, në mënyrë që të jetë në përputhje me ndryshimet e Legjislacionit të BE-së dhe Legjislacionit vendor.

Andaj me datë 05.02.2024 me nr.protokoli 575/02 Sekretari i Përgjithshëm i MINT ka formuar grupin punues për hartimin e draftit fillestar të Koncept Dokumentit për Kontrollin e tregtisë me mallra strategjike.Po ashtu me datë 27.02.2026 me nr.oprotokoli 844/02 u.d.Sekretari i Përgjithshëm me vendim ,sërish ka formuar grupin punues për hartimin e koncept dokumentit ,për shkak të ngecjeve në proces shkaku i mosfunksionimit të Kuvendit të Kosovës. Gjithashtu, Koncept Dokumenti në Fushën e kontrollit të tregtisë me mallra strategjike është përfshirë edhe në listën e Koncept Dokumenteve për vitin 2024 dhe 2026. Qëllimi i këtij Koncept Dokumenti

është që të propozojë opsionin më adekuat për të kontrolluar tregtinë me mallra strategjike dhe për tu harmonizuar me Rregulloret dhe Direktivat e BE-së.

Andaj, bazuar në udhëzuesin dhe doracakun për hartimin e koncept dokumenteve është hartuar ky dokument i cili do të propozojë opsionin e rekomanduar nga grupi punues bazuar në analizën lidhur me legjislacionin në fuqi për kontrollin e tregtisë me mallra strategjike në Kosovë.

Figura 1: Tabela me informacione të përgjithshme për koncept dokumentin

Titulli	Koncept Dokumenti në fushën e kontrollit të tregtisë me mallra strategjike
Ministria bartëse	Ministria e Industrisë, Ndërmarrsisë , Tregtisë dhe Inovcionit - DKTMS
Personi kontaktues	Zana Kotorri – Drejtore e Departamentit për Kontrollin e Tregtisë me Mallra Strategjike , zana.kotorri@rks-gov.net
PKZHE 2024-2026	Pjesë e PKZH 2026 - 2028. Qëllimi strategjik: - Ndërtimi i një mjedisi biznesi të drejtë, të adaptueshëm dhe konkurrues. Masa strategjike: - Përmirësimi i rregullatorit, unifikimi dhe përmirësimi i shërbimeve ndaj biznesit. Aktiviteti: - Hartimi dhe miratimi i koncept dokumentit për kontrollin e tregtisë me mallrat strategjike në harmoni të plotë me praktikat dhe standardet e BE-së.
Prioriteti strategjik	Ndërlidhja me disa prioritete strategjike të Qeverisë së Republikës së Kosovës 1. Plani Kombëtarë për Integrim Evropian 2026-2030 Blloku III: Standardet Evropiane – Përafrimi i Legjislacionit të Kosovës me Acquis-në e BE-së 3.30. Kapitulli 30 i acquis-së: Marrëdhëniet me jashtë. 3.30.2. Koncept Dokumenti për fushën e kontrollit të tregtisë me mallrat strategjike, i miratuar. 2. Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025 2.8. Industria, ndërmarrësia dhe tregtia; 2.8.1 Përmirësimi i mjedisit të të bërit biznes;

Grupi punues	Përfaqësues të ministrive, agjencive të mëposhtme të linjës: <ul style="list-style-type: none"> - Zana Kotorri – DKTMS / MINTI- Kryesuese - Driton Ademi –DKTMS / MINTI- zv.Kryesues - Behram Mazreku – DKTMS / MINTI - Arlinda Sadikaj -D.Ligjor /MINTI - Besarta Binaku – D.Financave/ MINTI - Dardan Nallbani - D.Integrimet / MINTI - Liridona Hoti - Z.Ligjore /ZKM - Shkurte Krasniqi – SKQ / ZKM - Albulena Blaku – Departamenti për Buxhet /MFPT - Bujar Pefqeli- Dogana e Kosovës - Blerim Bajramaj - MPJD - Fidaim Elshani – MM - Mensur Hoti - MPB
Informata shtesë	Nuk ka informata shtesë

Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit;

Departamenti për Kontrollin e Tregtisë me Mallra Strategjike (DKTMS) është organ i vetëm i administratës shtetërore që është përgjegjës për fushën e kontrollit të tregtisë me mallra strategjike në Republikën e Kosovës. DKTMS funksionon e ndarë në dy Divizione ;

- **Divizionit për mallra me përdorim të dyfishtë,**
- **Divizionit për mallra ushtarake, tranzit, broker dhe shërbime të ndërmjetësimit**

Në pajtim me rregulloren përkatëse për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësis dhe Tregtisë , DKTMS në kuadër të mandatit të saj ka përgjegjësi si në vijim

DKTMS ka fushëveprim kontrollin e eksportit,importit,transitit,trans-shipit,ri-eksportit,transferimin, ri-transferimin dhe veprimtaritë ndërmjetësuese për mallrat me përdorim të dyfishtë, mallrat ushtarake dhe teknologjitë si dhe shërbimet e ndërlidhura për sigurimin e interesave kombëtare të Republikës së Kosovës.

DKTMS mbikëqyr respektimin e traktateve ndërkombëtare për mospërhapjen e armëve të shkatërrimit në masë dhe sistemet e lëshimit të tyre, transferimin e armëve konvencionale, si dhe zbatimin e masave që synojnë parandalimin e përhapjes dhe përdorimit të këtyre mallrave për qëllime të kundërligjshme.

DKTMS është pikë e kontaktit për bashkëpunimin me shtetet tjera, palë në protokollin e OKB-së, kundër fabrikimit dhe trafikimit të paligjshëm të armëve të zjarrit, pjesëve dhe komponentëve të tyre si dhe të municioneve.

DKTMS për përmbushjen e detyrimeve ligjore bashkëpunon ngushtë me institucione dhe subjektet tjera rreth të dhënave për transferimet ndërkombëtare të mallrave, të cilat janë të detyruara t'i japin DKTMS-se në ushtrimin e funksioneve për kontrollin e

eksporteve,të gjitha të dhënat dhe ekspertizën e nevojshme. DKTMS mund t'i përdorë dhe t'i shkëmbejë këto të dhëna me agjencitë tjera ndërkombëtare homologe,vetëm për qëllime të kontrollit të eksporteve dhe për mbrojtjen e interesave kombëtare.Shkëmbimi i informacionit për transferimet ndërkombëtare të mallrave nuk duhet të jetë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe me interesa kombëtare.

Në kuadër të DKTMS **kryhen këto detyra:**

- Asistimi dhe këshillimi përkitazi me çështjet e mallrave me përdorim të dyfishtë dhe mallrave ushtarake ;
- Propozohen artikujt apo mallrat për ti futur në lista të kontrollit;
- Përgatiten vlerësimet dhe shqyrtimet fillestare të aplikacioneve (kërkesave) të mallrave me përdorim të dyfishtë dhe mallrave ushtarake në përputhje me politikat dhe udhëzimet e miratuara, para dorëzimit të tyre për miratim në Komision;
- Procedon regjistrimin e mallrave me përdorim të dyfishtë dhe mallrave ushtarake, garancive mbi përdorimin e fundit, përdoruesit e fundit, aplikacioneve (kërkesave) dhe korrespondencës tjetër;
- Kryen klasifikimin e artikujve të mallrave me përdorim të dyfishtë dhe mallrave ushtarake , duke i krahasuar ato me Listën e mallrave me përdorim të dyfishtë dhe Listën e mallrave ushtarake;
- Analizon efektet ekonomike të aktiviteteve kontrolluese të tregtisë strategjike mbi sektorët kyç të industrisë për të vlerësuar kapacitete e atyre sektorëve që t'i përkrahin kërkesat e sigurisë kombëtare të Kosovës;
- Përcjellë politikat e BE-së lidhur me kontrollin e këtyre mallrave ;
- Identifikon teknologjitë kryesore, pozitën tregtare në masë të atyre teknologjive, shqyrtimin e praktikave dhe regjimeve relevante multilaterale të kontrollit të eksportit të asaj teknologjie;
- Pjesëmarrja në aktivitetet e pajtueshmërisë dhe zhvillimin e programeve të brendshme të pajtueshmërisë;
- Kontrollon dhe mbikqyr regjistrat, procesverbalet dhe të dhënat statistikore si në mënyrë manuale ashtu edhe kompjuterike;
- Realizon inspektime tek operatorët ekonomik para, gjatë dhe pas përfundimit të licencimit ;
- Siguron zbatimin në Republikën e Kosovës, të listave të kontrollit të regjimeve ndërkombëtare të mospërhapjes dhe të kontrollit të eksporteve, marrëveshjes së Wassenaar-it për kontrollin e eksporteve të armëve konvencionale, mallrave dhe teknologjive, me përdorim të dyfishtë, grupit të Australisë, grupit të Furnizuesve Bërthamorë, Komitetit Zangger, Regjimit të kontrollit të teknologjive për raketat, Kodit të Hagës për parandalimin e raketave balistike etj.
- Shqyrtimi i licencimit ushtarak për të përcaktuar përshtatshmërinë e pranuesit të mallit dhe kryen analizë për të përcaktuar besueshmërinë dhe mundësitë e rrezikut për diversion nga pranuesit e mallrave ushtarake dhe shërbimeve të ndërlidhura;

- Zbaton kontrollin unilateral kombëtare në Kosovë për të siguruar se tregtia me mallra strategjike dhe ofrimi i shërbimeve të ndërlidhura janë në përputhshmëri me objektivat kombëtare të sigurisë që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, kontrollin e krimit, antiterrorizmin dhe stabilitetin rajonal, etj.
- Gjatë viteve 2023 dhe 2024 nga DKTMS janë lëshuar 255 licenca individuale importi për mallra ushtarake për përdorim civil ,procedurë kjo e cila është e parapare me Ligjin aktual. Në të njëjtën kohë këto licenca lëshohen edhe nga MPB/DSP, të cilat po ashtu janë të parapara me ligjin për arme e që krijojnë duplikim të procedurave, byrokraci e në të njëjtën kohë edhe ngarkesë administrative dhe kosto shtesë për operatorët ekonomik.

Mungesa e kapaciteteve administrative, numri i vogël i stafit , përmirësimi i vazhdueshëm i kapaciteteve administrative në fushën e zbatimit të legjislacionit është evident dhe vazhdon të jetë sfidë për DKTMS-në.

Problemet aktuale në këtë fushë janë si rezultat i shkaqeve të identifikuar si në vijim,

- Mungesa e dispozitave ligjore të harmonizuara me ndryshimet dhe risit në legjislacionin e BE-se, konkretisht Rregullores 2021/821 mbi kontrollin e eksporteve .
- Përzierja e kompetencave / kolezion i ligjeve dhe mos harmonizimi në mes të Ligjit nr.04/L-198 për Kontrollin e Tregtisë me Mallra Strategjike dhe Ligjit nr.05/L-022 për Armë / MPB.
- Mos harmonizim me Ligjin Nr.04/L-202 për sistemin e lejeve dhe licencave.
- Mos harmonizimi i gjobave me Ligjin Nr.05/L-087 për Kundërvajtje.

Figura 2 – Lista e akteve më të rëndësishme të *acquis* nga fusha e kontrollit te tregtisë me mallra strategjike

N r.	Dispozitat e Traktatit / Rregulloret / Direktivat / Legjislacioni dytësor	Përmbajtja dhe qëllimi	Legjislacioni vendor që transponon <i>acquis</i> të BE-së dhe niveli i përputhshmërisë
1	Rregullorja BE 2020/174	Rregullorja e Komisionit (BE) 2020/174 që ndryshon Rregulloren e Këshillit (KE) 428/2009 për përcaktimin e një regjimi për kontrollin e eksporteve, transferimit, brokerimit, dhe transitimit të mallrave me përdorim të dyfishtë.	Vendim QRK nr.16/42 i datës 27.10.2021. Pjesërisht
2	Rregullorja BE 2023/66	Rregullorja BE 2023/66 që ndryshon Rregulloren 2021/821 për mallrat që vihen nën kontroll për shkaqe të sigurisë kombëtare, politikës së jashtme,	Vendim QRK nr.08/136 i datës 22.03.2023. Pjesërisht

		sigurisë publike ose për arsye të të drejtave të njeriut.	
3	Pozicioni i përbashkët i Këshillit 2008/944/CFSP	Pozicioni i përbashkët i Këshillit 2008/944/CFSP i datës 8 dhjetor 2008 që përcakton rregullat e përbashkëta që rregullojnë kontrollin e eksporteve të teknologjisë dhe pajisjeve ushtarake dhe që zëvendëson listën e përbashkët ushtarake të BE-së të miratuar nga Këshilli me 22.02.2022 (CFS(2023/C72/02).	Vendim QRK nr.11/138 i datës 12.04.2023. Pjesërisht

Tabela; Dokumentet përkatëse të politikave , ligjet dhe aktet nënligjore;

Dokument i politikave, ligj ose akti nën-ligjor	Lidhja me politikën apo dokumentin planifikues përmes internetit ose me aktet ligjore në Gazetën Zyrtare	Institucioni(-et) shtetëror (e) përgjegjës(e) për zbatim	Roli dhe detyrat e Institucionit (-eve)
Ligji nr.04/L-198 për Tregtinë me Mallra Strategjike	Gazeta zyrtare https://rks.gov.net/	Qeveria e Kosovës dhe Ministrinë	Zbatimi dhe implementimi i ligjeve dhe akteve nënligjore nga DKTMS/ MINT është sponsorizues i kornizës ligjore
Rregullore (QRK) nr. 35/2013 Për funksionimin e punës së komisionit për kontrollin e tregtisë me mallra strategjike	https://gzk.rks.gov.net/	MIET MPPB,MPJ D,MM,DK	Shqyrtimi, kontrolli dhe vendimarrja lidhur me tregtinë e mallrave strategjike.

UA (MINT) nr.03/2021 Për regjistrimin dhe licencimin e operatorëve për tregti me mallra strategjike	https://gzk.rks-gov.net/	MIET	Kriteret e përcaktuara për aplikim të cilat operatorët duhet ti plotesojnë , rreth pajisjes me certifikata dhe licenca.
UA (MINT) nr.02/2016 Për formularin e regjistrimit, licencimit ,të klasifikimit dhe të certifikimit të tregtisë me mallra strategjike dhe shërbime të nderlidhura.	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.a	MIET	Formularët, aplikacionet , kërkesat për aplikim për tu pajisur me certifikata dhe licenca.
Ligji për Armë nr.05/L-022 MPB	Gazeta zyrtare https://rks-gov.net	MPB	Zbatimi dhe implementimi i ligjeve dhe akteve nënligjore nga DSP/ MPB është sponsorizues i kornizës ligjore
U.A (MPB) NR.08/2023 Për objektet dhe procesin teknologjik të prodhimit të armëve, pjesëve të armëve dhe municionit .	https://gzk.rks-gov.net/	MPB	Ky udhëzim administrativ ka për qëllim që të përcaktojë kushtet minimale teknike dhe ato të sigurisë që duhet t'i plotesojnë objektet ku do të bëhet prodhimi, shitblerja e armëve, pjesëve të armëve dhe municionit.
U.A (MPB) NR.09/2017 Për armët koleksionuese.	https://gzk.rks-gov.net/	MPB	Ky udhëzim administrativ përcakton kriteret për armët të cilat mund të koleksionohen në bazë të lejes së lëshuar nga Organi Kompetent.
U.A (MPB) NR.04/2017 Për përdorimin e armëve dhe municioneve të kategorisë C8 për pasivizim të përkohshëm të kafshëve	https://mpb.rks-gov.net/	MPB	Ky udhëzim administrativ ka për qëllim përcaktimin e procedurave për pajisje që përfshihen me armët dhe municionit për pasivizim të përkohshëm të kafshëve.

U.A.(MPB) NR.08/2016 Për kushtet minimal teknike për ruajtjen e armës,pjesëve të armës dhe municionit.	https://kryeministri.rks-gov.net/	MPB	Me këtë udhëzim administrativ përcaktohen kushtet minimale teknike për ruajtjen e armëve, pjesëve të armës dhe municionit në vende të sigurta, të cilat duhet të përmbushen nga personat fizik dhe personat juridik.
U.A (MPB) Nr. 09/2016 Për katalogun e llojeve të armëve	https://gzk.rks-gov.net/	MPB	Me këtë udhëzim administrativ përcaktohen llojet e armeve, pjesëve te armës dhe municionit që mund të blihen nga personi fizik dhe juridik në bazë të pëlqimit të lëshuar nga organi kompetent, sipas kategorizimit të armëve B dhe C.
U.A (MPB) NR. 03/2016 Për leje për lëvizje me armë	https://gzk.rks-gov.net/	MPB	Ky Udhëzim Administrativ rregullon procedurat dhe kriteret për lëshimin dhe përdorimin e lejes për lëvizje me armë.
U.A (MPB) NR. 25/2010 Për gjurmimin e armëve të zjarrit, pjesëve të tyre dhe municionit	https://gzk.rks-gov.net/	MPB	Qëllimi i këtij Udhëzim Administrativ është që të rregulloj mënyrën dhe kushtet e gjurmimit të armëve të zjarrit ,dhe kur është e mundur pjesët e tyre dhe municionin, me kohë dhe mënyrë të përshtatshme.
U.A (MPB) NR. 26/2010 Për shënjimin e armëve të zjarrit, pjesëve dhe municionit të tyre.	https://gzk.rks-gov.net/	MPB	Ky Udhëzim Administrativ rregullon mënyrën e shënjimit të armëve të zjarrit,pjesëve ,municionit dhe paketimit të municionit, si një nga elemnete thelbësore në identifikimin e armëve dhe municionit,që synon parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit që ndërlidhet me armë.
U.A (MPB) NR. 27/2010 Për mënyrën e transferimit të armëve , pjesëve të tyre dhe municionit,përtej kufirit shtetëror.	https://gzk.rks-gov.net/	MPB	Ky Udhëzim Administrativ përcakton proceduart dhe mënyren e transferimit të armëve, pjesëve të tyre dhe municionit përtej pikës kufitare shtetërore për personat fizik dhe juridik,si dhe procedurat e miratimit të ftesave për aktivitete të gjuetisë dhe garat e shenjëtarisë për personat fizik ose për anëtarët e shoqatave të shenjëtarisë.

Ligji (MPB) Nr.03/L-246 për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuara shtetërore për siguri.	https://gzk.rks-gov.net/	MPB	Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i dispozitave ligjore lidhur me pajisjen me armë, municion dhe pajisje përkatëse për siguri për institucionet e autorizuara shtetërore për siguri.
U.A (MPB) NR. 02/2016 Për lejen e eksportit të përkohshëm, verifikimin e importit nga përdoruesi i fundit, masat e sigurisë të institucioneve të autorizuara shtetërore për caktimin e personit përgjegjës dhe kriteret për përcjellje gjatë transportit të PQV-ve.	https://gzk.rks-gov.net/	MPB	Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është përcaktimi i procedurës për lëshimin e lejes për eksportim të përkohshëm të PQV-së, verifikimin e importit nga përdoruesi i fundit, masat e sigurisë të institucioneve të autorizuara shtetërore për siguri, që do të jenë përgjegjëse për caktimin e një personi përgjegjës dhe kriteret për përcjellje, përjashtimisht kur transportimi i PQV-së bëhet nga organet e autorizuara shtetërore për qëllime operationale .
U.A (MPB) NR. 04/2016 Për listën e autorizuar të pajisjeve për qëllime të veçanta për institucionet shtetërore të sigurisë.	https://gzk.rks-gov.net/	MPB	Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është përcaktimi i procedurës për hartimin dhe miratimin e listës së autorizuar të pajisjeve për qëllime të veçanta për institucionet e autorizuara shtetërore të sigurisë
Ligji nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve	https://gzk.rks-gov.net/	Institucionet e Republikës së Kosovës	Ky ligj përmban parimet themelore dhe rregullat e përgjithshme për të gjitha marrëdhëniet e detyrimeve. Dispozitat e këtij ligji zbatohen ndaj marrëdhënieve të detyrimeve të rregulluara me akte të tjera ligjore në lidhje me çështjet që nuk rregullohen në këto akte.
Ligji Nr.04/L-202 për sistemin e	https://gzk.rks-gov.net/	Institucionet e	Ky ligj ka për qëllim të vendos parimet dhe rregullat për përmirësimin e mjedisit për të bërë biznes, nëpërmjet reduktimit të barrierave

lejeve dhe licencave		Republikës së Kosovës	administrative, në kryerjen e veprimtarive ekonomike, tregtare apo profesionale, që është e domosdoshme për të mbrojtur shëndetin publik, sigurinë publike, mjedisin dhe përdorimin e resurseve natyrore në Republikën e Kosovës. Ky ligj rregullon të gjitha rregullimet që i bëhen veprimtarisë private dhe publike nga cilido institucion publik në Republikën e Kosovës
Ligji Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje	https://gzk.rks.gov.net/	Institucionet e Republikës së Kosovës	Me këtë ligj rregullohen kushtet për përcaktimin e kundërvajtjeve dhe sanksioneve për kundërvajtje, palët dhe përgjegjësia për kundërvajtje, procedura e kundërvajtjes, procedura e veçantë për të mitur dhe procedura e ekzekutimit të sanksioneve për kundërvajtje.
Regullorja e BE-se 821/2021 mbi kontrollin e eksporteve	https://eur-lex.europa.eu/eli/reg/2021/821/oj		Rregullimi i procedurave të kontrollit të eksportit, ndërmjetësimit, asistencës teknike, tranzitit dhe transferimit të mallrave me përdorim të dyfishtë të cilat janë riformuluara.
Direktivat e BE – se aktuale (plotesim ndryshimet)			

Problemi kryesor

Në këtë nën-kapitull është paraqitur pema e problemit e cila përmban problemin kryesor, shkaqet dhe efektet e tij. Të njëjtat gjithashtu janë analizuar në pjesën narrative si më poshtë;

Figura 3: Pema e problemit, që paraqet problemin kryesor, shkaqet e tij dhe efektet

Efektet	<ul style="list-style-type: none"> • Dëmtimi i operatorëve ekonomik dhe konkurrencës : • Ngarkesë dhe burokraci në të bërit biznes : • Procedura të kontrollit dhe licencimit jo në harmoni me praktikën ndërkombëtare. • Rrezikimi i sigurisë dhe mbrojtjes së interesave të Republikës së Kosovës në obligim me politikën e jashtme shtetërore.
Problemi kryesor	Mosharmonizimi i Ligjit në fuqi 04/L-198 për Tregtisë e Mallra Strategjike, komfor ndryshimeve të Rregulloreve dhe ligjeve të BE-së dhe Legjislacionit vendor që ndërlikohet me fushën e kontrollit të mallrave strategjike.

<p>Shkaqet</p>	<p>1.Rregulla të pakompletuara në procese dhe procedura të kontrollit si shkak i mos harmonizimit të Ligjit për tregti me mallra strategjike me përditësimet dhe ndryshimet e Legjislacioni të BE-së, kryesisht mungesa e ,</p> <p>Transpozimit të Regullorës së BE-së 2021/821 për vendosjen e një regjimi për kontroll të eksportit, ndërmjetësimit, asistencës teknike , tranzitit dhe transferimit të mallrave me përdorim të dyfishtë të cilat janë riformuluar.</p> <p>Zbatimi i Listës së Mallrave me Përdorim të Dyfishtë /EU 2025/2616</p> <p>Zbatimi i Listës së Përbashkët për Mallra dhe Pajisje Ushtarake a Bashkimit Evropian të miratuar nga Këshilli më 19 shkurt 2024) CFSP 2024/C pajisjet e mbuluara nga Pozicioni i Përbashkët i Këshillit 2008/944/CFSP që përcakton rregullat e përbashkëta që rregullojnë kontrollin e eksporteve të teknologjisë dhe pajisjeve ushtarake</p> <p>Zbatimi i Traktatit për Tregti të Armëve ;</p> <p>Zbatimi i Qëndrimi i përbashkët i Këshillit të BE-së 2008/944/CFSP 8 dhjetor 2008</p> <p>Zbatimi i Qëndrimi i përbashkët i BE-së 2003/468/CFSP e 23 qershorit 2003 mbi kontrollin e brokerimit të armeve ;</p> <p>Raportimi në Raportimi në UNROCA - UN Register of Conventional Arms</p> <p>Rezoluta 1540-respektimi i të drejtave të njeriut</p> <p>Mos harmonizim me ndryshimet dhe transpozimi me legjislacionin e BE-së (Rregulloret, direktivat, traktate, qëndrimet e përbashkëta)</p> <p>Zbatimi i Veprimi i përbashkët i Këshillit i datës 22 qershor 2000 lidhur me kontrollin e asistencës teknike në lidhje me disa përdorime ushtarake të fundit etj.</p>
	<p>2.Rregulla kontradiktore në mes të Ligjit nr.04/L-198 për Tregtinë e mallrave strategjike dhe Ligjit nr.05/L-022 për Armë</p> <p>Të dy ligjet rregullojnë fushen e importit për kategoritë e mallrave të njejta e që krijojnë byrokraci, duplifikimi të licencave ,ngarkesë dhe kosto administrative.</p> <p>Ligji për Tregtinë e mallrave strategjike përfshinë në fushëveprim përveç kontrollit të eksportit mbulon edhe kontrollin e importit të mallrave dhe pajisjeve ushtarake të përcaktuara sipas Listës së mallrave ushtarake të EU-së, e cila adaptohet dhe implementohet nga Kosova .</p> <p>Armët e përcaktuara në kategoritë ; ML , ML2, ML13 të listës së mallrave ushtarake licencohen nga DKTMS e po të njejtat kategori të këtyre mallrave të cilat importohen në Republikën e Kosovës licencohen edhe nga DSP / MPB referuar fushëveprimin të Ligjir nr.05/L-22 për Armë. Me këtë rast me automatizëm vie tek duplifikimi i procedurave byrokratike , ngarkesës dhe kosto për bizneset.</p> <p>Kjo duhet të rregullohet ku importi dhe eksporti i armëve për përdorim civil te kontrollohet dhe licencohet nga MPB. Ndërsa kontrolli i importi dhe eksportit te mallrave ushtarake për nevoja të institucionve të sigurisë së vendit të kontrollohet nga MINT , konkretisht Ligji për tregtinë me mallra strategjike , gjithnjë referuar praktikave dhe standareve të vendeve të BE-së.</p>
	<p>3.Rregulla që shkaktojnë ngarkesë të panevojshme me Ligjin Nr.04/L-202 për sistemin e lejeve dhe licencave.</p> <p>Harmonizimi i Përkufizimeve për leje , licenca dhe regjistrim.</p>

	<p>4.Mos harmonizimi i afateve për shqyrtimin e ankesës me Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative</p> <p>Afatet për shqyrtim të kërkesave të Operatorëve Ekonomik me rastin e aplikimeve për tu pajisur me licenca apo certifikata të parapara me Ligjin nr.04/L-198 për Tregtinë me Mallra Strategjike nuk janë të harmonizuara me Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.</p>
	<p>5.Mos harmonizimi i gjobave me Ligjin Nr.05/L-087 për Kundërvajtje</p> <p>Harmonizimi për Sanksionet administrative dhe Sanksionet penale të parapara me Ligjin nr.04/L-198 për Tregtinë me Mallra Strategjike nuk janë në harmoni me Ligjin Nr.05/L-087 për kundërvajtje.</p>

Shkaqet;

1.Mangësi në procesese dhe procedura të kontrollit si shkak i mos harmonizimit të Ligjit nr.04/L-198 për tregti me mallra strategjike me përditësimet dhe ndryshimet e Legjislacioni të BE-së,

Aaliza 1:

Ligji nr.04/L-198 për Tregtinë me Mallra Strategjike duhet të harmonizohet me ***Rregulloren e BE-së 2021/821 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit***, për vendosjen e një regjimi në Bashkim për kontrollin e eksportit,ndërmjetësimit, asistencës teknike, tranzitit dhe transferimit të artikujve me përdorim të dyfishtë.

Termet /përkufizimet brenda ligjit nuk janë të harmonizuar me Rregulloren e BE-se 2021/821,si

- Eksporti
- Asistenca teknike
- Kërkesat e autorizimit për asistencë teknike
- Autorizimet për projekte të mëdha
- Të përgjithshme
- Autorizimet
- Procedurat doganore
- Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve
- Masat e kontrollit
- Catch-all kontrolli
- Procedurat e regjistrimit në regjistër /pajisja me certifikatë
- Procdeurat dhe fushëveprimi i kontrollit
- Detyrimet e persnave që merren me tregti të mallrave strategjike

2. Përziera e kompetencave /Kolezion i ligjeve në mes Ligjit nr.04/L-198 për Tregtinë me Mallra Strategjike dhe Ligjit nr. 05/L-022 për Armë

Analiza 2:

- **Ligjit nr.04/L-198 për Tregtinë me Mallra Strategjike** -rregullon eksportin, importin, transitin, trans-ngarkimin, ri-eksportin dhe ri-transferimin e mallrave strategjike, ofrimin e shërbimeve të ndërlidhura, si dhe kontrollin, mbikëqyrjen, të drejtat dhe detyrimet e palëve që marrin pjesë në aktivitetet e biznesit nga kjo fushë. Qëllimi i këtij ligji është ta avancojë sigurinë shtetërore dhe interesat e politikës së jashtme të Republikës së Kosovës, drejt përmbushjes së detyrimeve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare në lidhje me mospërhapjen e armëve të shkatërrimit në masë dhe mallrave tjera strategjike të shfrytëzuara për qëllime ushtarake dhe t'i kontribuojë përpjekjeve ndërkombëtare dhe rajonale për rregullimin e tregtisë me mallrat strategjike.
- **Ligjit nr. 05/L-022 për Armë MPB** – rregullon kushtet për blerjen, posedimin, armëmbajtjen, ruajtjen, prodhimin, çaktivizimin, riparimin, tregtimin, importimin, transitin, shitjen, transportimin dhe shënjimin e armëve dhe municionit për personat fizik dhe juridik, brenda territorit të Republikës së Kosovës, si dhe eksportimin nga Republika e Kosovës të destinuara vetëm për përdorim civil. Ky ligj është në përputhshmëri me Rregulloren (BE) nr. 258/2012 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 14 mars 2012, që implementon nenin 10 të Protokollit të Kombeve të Bashkuara kundër prodhimit ilegal dhe trafikimit me armë, pjesëve të tyre, përbërësve dhe municionit, që e plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Transnacional (Protokollin e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Transnacional (Protokollin e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Transnacional (Protokollin e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Transnacional (Protokollin e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Transnacional (Protokollin e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Transnacional dhe krijimi i autorizimit të eksportit, dhe importit dhe masat transite të armëve, pjesëve të tyre, përbërësve dhe municionit dhe Direktivën e Këshillit 91/477/KEE mbi kontrollin e marrjes dhe posedimit të armëve e ndryshuar me Direktiven 2008/51/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 21 maj 2008. Tregtia e armatimit, pajisjeve, armëve pjesëve të armëve dhe municionit, për qëllime ushtarake , i nënshtrohet Ligjit për Tregtinë e Mallrave Strategjike.

Neni 24 Llojet e lejeve për personat juridik

Neni 29 Leja për tregti me armë, pjesë të armëve dhe municion

Neni 30 Leja për transport me armë, pjesë të armëve dhe municion

Neni 55 Licenca për tregti me armë, pjesë të armëve dhe municion

Neni 59 Licenca për transport të armëve ,pjesëve të armëve dhe municionit

3. Harmonizimi me Ligjin Nr.04/L-202 për sistemin e lejeve dhe licencave.

Analiza 3: Harmonizimi i Përkufizimeve për leje , licenca dhe regjistrim sipas Ligjin Nr.04/L-202 për sistemin e lejeve dhe licencave, refreuar neneve si në vijim:

Neni 5 Llojet e lejimeve

Neni 7 Regjistrimet

Neni 8 Leja

Neni 14 Qasja Elektronike publike në informata

Neni 18 Taksat

Neni 27 E drejta per ankesë ndaj nje vendimi administrativ

4. Harmonizimi i gjobave me Ligjin Nr.05/L-087 për Kundërvajtje

Analiza 4:

- Sanksionet administrative të parapara me **Neni 30 të Ligjit nr.04/L-198** për Tregtinë e Mallrave Strategjike nuk janë në harmoni me **Ligjin Nr.05/L-087** për kundërvajtje.

Figura 2: Pasqyrë e palëve të interesuara bazuar në përkufizimin e problemit

Emri i palës së interesuar	Shkaku-qet dhe/ose efekti (efektet) me të cilat është e lidhur pala	Mënyra me të cilën pala është e lidhur me këtë shkak (shkaqe) apo efektin (efektet)
DKTMS/MINT	Mangësitë ligjore	Puna e DKTMS-së vështirësohet nga mangësitë e elaboruara më lartë.
DPS/MPB	Mos efikasiteti i procesit të kontrollit dhe licencimit si shkak të përzierjes së kompetencave në mbikëqyrjen e tregtisë me mallra strategjike .	Inspektimi/ Mbikëqyrja e tregtisë me mallra strategjike nuk kontrollohet mjaftueshëm për të siguruar zbatimin e ligjit për shkak të përzierjeve të kompetencave
Doganat e Kosovës	Efikasiteti i procesit të mbrojtjes së operatoreve nga pajisjet/mallrat e futura ilegalisht apo pa licencim.	Në mbrojtje të kontrollit të tregut dhe operatorëve ekonomik, nga pajisjet/mallrat me origjinë të dyshimtë dhe pa dëshmi të saktësisë së pajisjeve/mallrave.

Analiza e transpozimit të nevojshëm të Acqui-s së BE-së

Duke marr parasysh dinamikën e procesit integruar të Kosovës në BE duhet të punohet në përfarimin e më tejme me acqise të BE-së veçanërisht gjatë përgatitjes së çfarëdo ndryshimi ligjor që mund të planifikohet.

- Transpozimit të Regullorës së BE-së 2021/821 për vendosjen e një regjimi për kontroll të eksportit,ndërmjetësimi,asistencës teknike, tranzitit dhe transferimit të mallrave me përdorim të dyfishtë të cilat janë riformuar.
- Zbatimi i Traktatit për Tregti të Armëve i cili ka vendosur standardet më të larta të mundshme të përbashkëta ndërkombëtare për rregullimin ose përmirësimin e rregullimit të tregtisë ndërkombëtare të armëve konvencionale;
- Zbatimi i Qëndrimi i përbashkët i BE-së 2003/468/CFSP e 23 qershorit 2003 mbi kontrollin e brokerimit të armeve;
- Zbatimi i veprimt të përbashkët të Këshillit të datës 22 qershor 2000 lidhur me kontrollin e asistencës teknike në lidhje me disa përdorime ushtarake të fundit etj.

Zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit

Sa i përket lëvizjes së lirë të mallrave, dispozitat e MSA-së kërkojnë që Republika e Kosovës përfshirë komentet të zbatojë rregullat e tregtisë së lirë me BE-në dhe në përputhje me këtë të zbatojë Marrëveshjen me GATT 1994 dhe dispozitat e përfshira përkatëse të Marrëveshjes së OBT-së.

Kosova obligohet të marrë masat e nevojshme për të arritur gradualisht konformitetin me legjislacionin horizontal dhe sektorial të BE-së në përputhje me standardet evropiane.

Në kuadër të nenit 11 të MSA-së theksohet se dialogu politik ndërmjet palëve do të zhvillohet më tej brenda kontekstit të kësaj marrëveshjeje. Ai do të shoqërojë dhe konsolidojë afrimin ndërmjet BE-së dhe Kosovës dhe do të kontribuojë në krijimin e lidhjeve të ngushta të solidaritetit dhe formave të reja të bashkëpunimit ndërmjet palëve.

Dialogu politik synon në mes të tjerave të promovojë rritjen e konvergencës me disa masa të politikave të përbashkëta të jashtme dhe të sigurisë, në veçanti masat kufizuese të marra nga BE-ja kundër vendeve të treta, personave fizikë ose juridikë ose subjekteve jo shtetërore, gjithashtu nëpërmjet shkëmbimit të informacionit sipas rastit, dhe në veçanti, për ato çështje që mund të kenë efekte thelbësore mbi palët.

Kosova ka zhvilluar Programin Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE) si një dokument kryesor strategjik kombëtar për planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e zbatimit të të gjitha reformave të nevojshme për zbatimin e MSA-së dhe fazat e ardhshme të anëtarësimit në BE.

Në PKIE 2024 - 2028, përkatësisht në bllokun tre: “Standardet Evropiane – Përafrimi i Legjislacionit të Kosovës me acquis së BE-së në kapitullin 30 – Marrëdhëniet me jashtë, DKTMS ka paraqitur masën afatshkurtër për miratimin e koncept dokumentit në fushën e kontrollit të tregtisë me mallrave strategjike.

Kapitulli 2: Objektivat

Qëllimi kryesor i politikës së propozuar është përmirësimi i kontrollit në fushën e tregtisë me mallra strategjike, si parakusht për funksionimin e lirë të tregut, mbrojtjen e operatorëve ekonomik dhe mundësimin e konkurrencës së drejtë, kontrollin dhe mbikqyrjen e avancimit të sigurisë shtetërore, Interesat e politikës së jashtme të Republikës së Kosovës drejt përmbushjes së detyrimeve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare.

Përputhshmëri më e lartë me standardet dhe praktikave të Bashkimit Evropian. Kjo politikë kontribuon në përmbushjen e prioriteteve të reformave ekonomike dhe institucionale që burojnë nga dokumentet strategjike, përkatësisht; Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025 dhe Programin Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE) 2026-2030.

Figure 3: Objektivat strategjike dhe specifike të Qeverisë

Qëllimi i politikës	Emri i dokumentit përkatës të planifikimit (burimi)
Strategjik - Ndërtimi i një mjedisi biznesi të drejtë , të adaptueshëm dhe konkurrues	PKZH 2026-2028
Specifik - Hartimi i legjislacionit primar dhe sekondar duke përfshirë harmonizimin e legjislacionit përkatës në fushën e kontrollit të tregtis me mallra startegjike	Sipas këtij Koncept Dokumenti
Specifik - Lehtësimi i procedurave tregtare për operatorët ekonomik sipas praktikave dhe procedurave Euroiane.	PKZH 2024–2028

Specifik - Thjeshtëzimi dhe digjitalizimi i mënyrës së aplikimit për ofrimin e shërbimeve në fushën e tregtisë me mallra startegjike	Koncept Dokumenti , Programi për parandalimin dhe zvogëlimin e barrës administrative.
Specifik - Zhvillimi i fushatës vetëdijsuese dhe informues	Sipas këtij Koncept Dokumenti

Kapitulli 3: Opsionet

Nga grupi punues janë trajtuar gjithsejt tri opsione për adresimin e problemit të identifikuar më lartë dhe arritjen e objektivave. Këto opsione janë: 1) opsioni asnjë ndryshim; 2) opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit pa ndryshime ligjore; 3) opsioni që parasheh ndryshime ligjore.

Krahasimi me vendet tjera

Grupi punues gjatë përgatitjes së këtij Koncept Dokumenti, ka marr parasysh përvojat e Republikës së Shqipërisë dhe Kroacisë, për të krahasuar qështje të identifikuara në Kapitullin 1 dhe që janë konsideruar të rëndësishme për tu krahasuar.

Çështja e trajtuar	Shqipëria	Kroacia
<p>Fusha e veprimit</p> <p>1.Procedurat e regjistrimit në regjistër / afati i certifikatës per regjistrim në r egjistër vetëm tek mallrat ushtarake.</p> <p>3.Kriteret e licencimit;</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji Nr.46/2018 për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë. Autoriteti përgjegjes per leshimiin e licencave e, certifikatave dhe vertetimeve eshte Autoriteti i Kontrollit Shteteror te Eksportit. • Ky ligj rregullon licencimin e veprimtarive që lidhen me transferimi ndërkombëtar të mallrave të kontrolluara, duke perfshire veprimtarite ndërmjetësuese, prodhimin , bashkëpunimin shkencor dhe teknik , si dhe ekspozimin e tyre në ekspozita, panaire ndërkombëtare për qëllime reklamimi, testim, marketingu dhe operacioneve lidhur me to , deri në përdorimin e fundit të tyre apo deri në mbërritjen e tyre te përdoruesi i fundit. 	<p>Ligji për mbikqyrjen e mallrave me përdorim të dyfishtë , me të cilin ligj sigurohet zbatimi i Rregullores së BE-së 2021/821 për vendosjen e një regjimi për kontroll të eksportit, ndërmjetësimi, asistencës teknike , tranzitit dhe transferimit të mallrave me përdorim të dyfishtë të cilat janë riformuluar.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Autoriteti përgjegjës për lëshimin e licencave për shërbime ndërmjetësimi / brokerimi, ndihmë teknike dhe licenca eksporti është Ministria e Punëve të Jashtme dhe Europiane. • Lëshim i licencave për eksport të mallrave me përdorim të dyfishtë, bëhet konform nenit 4 dhe 5 të Rregullorës së BE-së 2021/821. • Lëshim i licencave eksportuese për shërbime ndërmjetësimi të mallrave me përdorim të dyfishtë, bëhet konform nenit 6 të Rregullores së BE-së 2021/821. • Lëshim i licencave për shërbime të ndihmës teknike të mallrave me përdorim të dyfishtë, bëhet

	<ul style="list-style-type: none"> • Personat fizikë/juridikë, të cilët paraqesin interes të kryejnë transferime ndërkombëtare të mallrave ushtarake ose do të angazhohen në veprimtari ndërmjetësimi, kanë detyrimin e regjistrimit tek AKSHE kundrejt paraqitjes së dokumentacionit për regjistrim dhe pajisjes me certifikatë regjistrimi. <p>Certifikata e regjistrimit është e vlefshme 3 vjet nga data e lëshimit.</p>	<p>konform nenit 8 të Rregullorës së BE-së 2021/821.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lëshimi i Certifikatës ndërkombëtare të Importit (International Import Certificate) bëhet kur Shteti eksportues i mallrave me përdorim të dyfishtë kërkon nga shteti importues , i njejt rast vlen edhe me Certifikatën e verifikimit të pranimit të mallrave (Delivery Verification Certificate),si dhe Certifikatën e Përdorimit të fundit (End-Use Certificate). <p>Obligimet e Ministrisë;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mbajtja e evidencës për licencat e lëshuara dhe realizimit të aktiviteteve tregtare në kuadër të licencave për mallrat me përdorim të dyfishtë. • Përgatitja e raportit vjetor për tregti me mallra startegjike deri më 30 prill të vitit pesues. • Me qëllim të respektimit të ligjit dhe Rregullores së BE-se 821/2021,Ministria bashkëpunon me organizata dhe regjime tjera ndërkombëtare nga fuhsa e kontrollit të tregtisë me mallra startegjike. <p>Masat ndëshkuese;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kushdo që importon, eksporton apo ofron shërbime ndërmjetësimi, asistencë teknike pa licencë për tregti të mallrave me përdorim të dyfishtë, apo nuk e njofton Ministrin për ndonjë ndryshim të përdoruesit të fundit që nga momenti i lëshimit të licences ,do të ndëshkohet sipas legjislacionit shtetëror në fuqi. <p>Ligji për mbikqyrjen e tregtisë me mallra ushtarake dhe municioneve joushtarake , i harmonizuar me Direktivat e Parlamentit dhe Këshillit të BE-së , si;</p>
--	--	---

	<ul style="list-style-type: none"> • Direktiva 2009/43/EZ • Direktiva 2012/47/EU • Qendrimete të përbashkëta të keshillit 2008/944/ZVSP • Qendrimete të përbashkëta të keshillit 2003/468/ZVSP • Veprimi i përbashkët i keshillit 200/401/ZVSP <p>Përgjegjësit e Institucioneve ;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ministria e Mbrojtjes, është përgjegjëse për lëshimin e licencave eksportuese për nevoja të forcave ushtarake, ndërsa Ministria e Punëve të Brendshme lëshon licenca për nevoja të policisë. • Ministria lëshon licenca individual importi dhe eksporti në afat në një vit, pa mundësi të zgjatjes së afatit. • Ministria lëshon licence globale eksporti për një apo disa shtete për nevoja ushtarake, tek kategoria ML13. • Certifikatat e përdoruesit të fundit për import të mallrave ushtarake për nevoja të forcave të armatosura të shtetit e lëshon Ministria e Mbrojtjes, ndërsa për nevoja të policisë dhe Ministria e punëve të brendshme.
--	--

Kapitulli 3.1: Opsioni asnjë ndryshim

Opsioni *asnjë ndryshim*, do të ruante status quon dhe problemi ekzistues “*Funksionimi jo i drejtë i kontrollit të tregtisë me mallra strategjike*” do të vazhdonte të krijonte efekte të pa dëshiruara në fushën e kontrollit. Ky opsion nuk do të adresonte shkaqet që prodhojnë efekte negative duke sjellë si pasojë një vazhdimësi të situatës momentale. Gjithashtu, status quo do të lejonte hapësirë për konfuzitet në interpretim të ligjit, përzierje të kompetencave institucionale, si dhe kosto shtesë për funksionimin e operatorëve në treg.

Kapitulli 3.2: Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit pa ndryshime ligjore

Opsioni për *përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit*, është një opsion që e parashikon procedura e hartimit në çdo Koncept Dokument në përputhje me Udhëzuesin për Hartimin e Koncept Dokumenteve. Ky opsion shikon në përmirësimin e mënyrave për arritjen e objektivave përmes zbatimit të duhur të detyrimeve ekzistuese ligjore. Në këtë kuadër, grupi punues mbas diskutimeve dhe analizave gjatë punëtorive të mbajtura ka propozuar që ekziston

mundësia të arrihen objektivat e koncept dokumentit duke e përmirësuar zbatimin e duhur të detyrave ekzistuese ligjore përmes ndarjes së buxhetit shtesë në rast se dispozitat aktuale buxhetore nuk janë të përshtatshme për arritjen e objektiveve. Në këtë mënyrë mundësohet që me buxhet të shtuar të synohen dy objektiva bazë siç janë; rritja e numrit të stafit, trajnimeve, si dhe aktiviteteve shtesë për sensibilizimin e operatorëve për t'iu përmbajtur dhe respektuar dispozitave ligjore në fuqi. Por në anën tjetër, ky opsion do të adresonte deri në një masë të caktuar efektet dhe shkaqet të cilat shpiten tek problemi kryesor që po analizohet në këtë Koncept Dokument. Gjithashtu, problemet që janë identifikuar në këtë Koncept Dokument janë kryesisht të ndërlidhura me bazën aktuale ligjore dhe si e tillë mund të adresohen vetëm me ndërhyrje në dispozitat ligjore në fuqi. Kështu që, në këtë rast do të duhej të merren parasysh me kujdes efektet e kostove totale buxhetore të këtij opsioni si dhe fakti që arritja e objektivave është në pjesë të madhe e bazuar në parashikime dhe paragjykime.

Kapitulli 3.3: Opsioni i tretë

Problemi që është identifikuar në këtë Koncept Dokument “**Funksionimi jo i drejtë i kontrollit të tregtisë me mallra strategjike**” është kryesisht i ndërlidhur me bazën aktuale ligjore. Rrjedhimisht, çfarëdo përmirësimi në zbatimin dhe ekzekutimin e dispozitave përkatëse ligjore në fuqi nuk do të prodhonin zgjidhje për problemin e identifikuar.

Opsioni i tretë, në anën tjetër, si mbas gjykimit dhe analizave të grupit punues paraqet opsionin që do të shkonte përtej përmirësimit të zbatimit dhe ekzekutimit të kornizës aktuale ligjore. Andaj, propozimi në këtë rast është për të zhvilluar **ligj të ri**.

Ky opsion është edhe rekomandimi nga grupi punues i Koncept Dokumentit. Përmes këtij opsioni synohet të arrihet ndryshimi i politikave ekzistuese, më konkretisht përmes hartimit të ligjit të ri për kontrollin e tregtisë me mallra strategjike, i cili do të duhet të merrte për bazë rekomandimet e më poshtme të dala nga analiza e këtij Koncept Dokumenti:

Rekomandimi 1: Në ligjin e ri Departamenti për kontrollin e tregtisë me mallra strategjike , do të organizohet dhe funksionojë me strukturë komplete në formë të departamentit DKTMS në pajtim me Rregulloren për organizimin dhe strukturimin e brendshëm të MINT.

Rekomandimi 2: Zbatimi i procedurave dhe praktikave më të mira të BE-së, do të bëhen përmes Transpozimeve të Rregullores, Direktivave , Qëndrimeve të përbashkëta të BE-se , e të cilat do të duhet të zbatohen edhe nga ana e Institucioneve të Republikës së Kosovës.

Kryesisht transpozimi i **Rregullores së BE-së 2021/821 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit** për vendosjen e një regjimi në Bashkim për kontrollin e eksportit, ndërmjetësimit, asistencës teknike, tranzitit dhe transferimit të artikujve me përdorim të dyfishtë.

Termet /përkufizimet brenda ligjit nuk janë të harmonizuar me Rregulloren e BE-se 2021/821, si

- Eksporti
- Asistenca teknike

- Kërkesat e autorizimit për asistencë teknike
- Autorizimet për projekte të mëdha
- Të përgjithshme
- Autorizimet
- Procedurat doganore
- Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve
- Masat e kontrollit
- Catch-all kontrolli
- Procedurat e regjistrimit në regjistër /pajisja me certifikatë
- Procedurat dhe fushëveprimi i kontrollit
- Detyrimet e persnave që merren me tregti të mallrave strategjike

Eksporti - Reformulimi ndryshoi përkufizimin e “eksportit” të paraparë në nenin 2 (2). Shumica e ndryshimeve të dispozitës në fjalë janë bërë kryesisht për të përafuar Rregulloren me Kodin Doganor të Bashkimit të vitit 2013 dhe Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) 2015/2446³, pasi që Rregullorja (KE) 428/2009⁴ i referohej Kodit Doganor Komunitar të 12 tetorit 1992⁵ dhe Rregullores së Komisionit (EEC) Nr. 2454/936. Siç përmendet në Recitalin 12 të Reformulimit, duke pasur parasysh rolin e rëndësishëm që luajnë autoritetet doganore në zbatimin e kontrolleve strategjike tregtare, është e domosdoshme që termat në Rregullore të jenë në përputhje me instrumentet ligjore të lartpërmendura.

- Rregullorja e mëparshme 428/2009 përcaktoi ‘eksportuesin’ – në nenin 2.3 (i) të saj – si çdo person fizik ose juridik ose ortakëri në emër të të cilit është bërë një deklaratë eksporti (që mban kontratën me marrësin në vendin e tretë në koha e pranimit të deklaratës në fjalë), ose person që përcakton dërgimin e artikujve në fjalë në një vend të tretë (në rastin e mungesës së deklaratës/kontratës ose në rast se një person/ortakëri nuk vepron në emër të tij). Reformulimi - në nenin 2 (3) (a) – përcakton “eksportuesin” në mënyrë të ngjashme, përveçse shton dhe specifikon se deklarata e mësipërme që do të bëhet dhe pranohet mund të jetë gjithashtu një “deklaratë ri-eksporti ose një deklaratë përmbledhëse dalje”. Arsyeja e këtyre shtesave lidhet me faktin se teksti duhej të rregullohej dhe harmonizohej në përputhje me përkufizimet që shtohen ose modifikohen në rregulloren e re, veçanërisht “deklarata përmbledhëse e daljes” dhe “deklarata e ri-eksportit” (në kuptim të: Kodit Doganor të ndryshuar të Bashkimit).
- Së dyti, ndërkohë që rregullorja e mëparshme e përkufizonte ‘eksportuesin’ – në nenin 2.3 (ii) – si çdo person (fizik ose juridik) ose ortakëri që angazhohet në transferime të paprekshme, d.m.th., duke transmetuar softuer ose teknologji (nëpërmjet mediave dhe/ose mjeteve elektronike) ose duke i bërë ato të disponueshme jashtë territorit të BE-së, reformulimi zgjerohet - në përputhje me nenin 2 (b) – fushëveprimi që lidhet me konceptin e “vënies së tyre në dispozicion” duke specifikuar “për personat fizikë ose juridikë ose ortakëritë jashtë territorit doganor të Bashkimit”. Ky ndryshim i vogël mund të kuptohet për të shmangur lënien e zonave të zbrazëta të interpretimit dhe zbatimit, si dhe për të qenë shterues dhe i saktë në formulimin e dispozitës dhe për t’u harmonizuar në të gjithë tekstin.

Asistenca teknike - ‘asistenca teknike’ nënkupton çdo mbështetje teknike në lidhje me riparimet, zhvillimin, prodhimin, montimin, testimin, mirëmbajtjen ose çdo shërbim tjetër teknik dhe mund të marrë forma të tilla si udhëzime, këshilla, trajnime, transmetim të njohurive

ose aftësive të punës ose shërbime konsulente përmes mjeteve elektronike si dhe telefonit ose ndonjë forme tjetër verbale të ndihmës. Për sa i përket formave që mund të marrë ndihma teknike, përkufizimi i ri shton se ajo mund të marrë formën e një këshille përmes mjeteve elektronike si dhe telefonit ose ndonjë forme tjetër verbale të ndihmës. Kjo e fundit duket se ka ndikim vendimtar në fushën e kontrollit të asistencës teknike për atë që përfshin çdo informacion përkatës të komunikuar me forma verbale, duke përfshirë jo vetëm një thirrje nga BE-ja në një vend të tretë, por edhe, ndër të tjera, shkëmbimin e atyre informacioneve kundrejt një rezidenti të një vendi të tretë i pranishëm përkohësisht në territorin doganor të BE-së⁹. Përkufizimi i ri i nenit 2(9) zgjeron gjerësisht fushëveprimin e Rregullores dhe rrjedhimisht të kontrolleve të aplikuara për eksportin e artikujve me përdorim të dyfishtë:

- Vetë përkufizimi i ‘asistencës teknike’ – ndryshe nga fushëveprimi i kontrolleve – mund të konsiderohet si i transpozueshëm në sistemet e kontrollit të eksportit të vendeve të treta. Ky kategorizim justifikohet me faktin se përkufizimi nuk është specifik për BE-në në asnjë mënyrë dhe për rrjedhojë i përshtatshëm edhe për sisteme të tjera. Për më tepër, përfshirja e konceptit dhe përkufizimit në sistemin e kontrollit të eksportit të një vendi është i dobishëm – nëse nuk është i nevojshëm – për të mbuluar të gjithë spektrin e aktiviteteve që lidhen me transferimin e artikujve me përdorim të dyfishtë.

Kërkesat e autorizimit për asistencë teknike- Neni 13 i Rregullores së BE-së për Përdorim të Dyfishtë 2021/821 i referohet procedurave të autorizimit për ndërmjetësim dhe asistencë teknike dhe synon unifikimin e procedurave brenda BE-së. Në mënyrë të veçantë, ai rregullon në nenin 13.1 kompetencat e shteteve anëtare bazuar në statusin e vendbanimit ose të themelimit të ndërmjetësit ose ofruesit të asistencës teknike.

- Në nenin 13.2 rregullohet përmbajtjen e autorizimeve për shërbime të ndërmjetësitimit dhe asistencës teknike dhe vlefshmëria e licencave në mbarë BE-në.
- Në nenin 13.3 rregullohet detyrimi i ndërmjetësve dhe ofruesve të asistencës teknike për t’i dhënë autoritetit kompetent “informacionin përkatës” për aplikimin e tyre.
- Neni 13.4 parashe se afati i vendimit për shqyrtimin e kërkesës për autorizim përcaktohet nga ligji ose praktika kombëtare. Kjo duhet të rrisë transparencën e procedurës.
- Së fundi, neni 13.5 përcakton domosdoshmërinë e lëshimit të licencave, kurdoherë që është e mundur, me mjete elektronike në modelet e përcaktuara për shërbimet e ndërmjetësitimit dhe formularët e autorizimit të asistencës teknike.
- Megjantë kjo dispozitë fokusohet ekskluzivisht në procedurat e autorizimit, ajo mund të konsiderohet si e transpozueshme dhe mund të zbatohet lehtësisht nga vendet e treta pa asnjë përshtatje. Parakusht për këtë zbatim është nevoja për të pasur dispozita për asistencë teknike dhe ndërmjetësim në legjislacionet kombëtare.

Autorizimet për projekte të mëdha- Neni 2(14) lidhur me ‘autorizimet për projekte të mëdha’ është paraqitur nga Rregullorja e re (BE) 2021/821. Ky autorizim për eksport, i cili mund të marrë formën e një autorizimi global ose individual, i jepet eksportuesit për një lloj ose kategori artikujsh me përdorim të dyfishtë të vlefshëm për eksporte në një ose më shumë vende të treta të specifikuar dhe përdorues fundor për qëllime të një projekti të caktuar në shkallë të gjerë. Ndryshe nga autorizimet globale të eksportit që janë përgjithësisht të vlefshme deri në dy vjet, autorizimet për projekte të mëdha mund të jepen deri në katër vjet. Kohëzgjatja e vlefshmërisë

së një autorizimi të tillë është detajuar në nenin 12.3 të Rregullores së re. Kjo dispozitë mund të konsiderohet tërësisht e transpozueshme dhe e dobishme për vendet e treta, bazuar në përmbajtjen e saj të përgjithshme e cila nuk lidhet me asnjë parim tregtar specifik të BE-së. Ky autorizim për projekte të mëdha synon të lehtësojë biznesin e eksportuesve dhe eksportet e artikujve me përdorim të dyfishtë të përfshirë në projekte të mëdha me akterë të shumtë. Siç është theksuar tashmë në nenin 12.3, autoriteti kompetent - i shtetit anëtar - përcakton kohëzgjatjen e autorizimit dhe lejon një përjashtim për vlefshmërinë e tij në rrethana të justifikuara siç duhet bazuar në kohëzgjatjen e projektit, kjo dispozitë mund të zbatohet qartë në kontekstin e autoritetit kombëtar të vendeve të treta.

Programi i Brendshëm i Përputhshmërisë (PBP) - Programi i brendshëm i përputhshmërisë (PBP) është një nga paraqitjet e reja kyçe të riformulimit të Rregullores së BE-së për Përdorim të Dyfishtë, e cila e përcakton atë në nenin 2(21) si “politika dhe procedura të vazhdueshme efektive, të përshtatshme dhe proporcionale të miratuara nga eksportuesit për të lehtësuar përputhjen me dispozitat dhe objektivat e kësaj rregulloreje dhe me termat dhe kushtet e autorizimeve të zbatuara në bazë të kësaj rregulloreje, duke përfshirë, ndër të tjera, masat e kujdesit të duhur për vlerësimin e rreziqeve që lidhen me eksportimin e artikujve tek përdoruesit përfundimtarë dhe në përdorimet përfundimtare.

- Kjo dispozitë mund të konsiderohet si e transpozueshme në sistemin e kontrollit të eksportit të vendeve të treta. Theksi i dhënë një programi efektiv të përputhshmërisë së brendshme përforcon besueshmërinë e eksportuesit. **PBP** ndihmon kompanitë dhe organizatat e tjera në menaxhimin dhe minimizimin e të gjitha rreziqeve që lidhen me kontrollet e eksportit dhe kërkesat e PBP-së mund të përshtaten në mënyrë të përshtatshme për eksportuesit e ndryshëm dhe rreziqet përcjellëse. Centralizimi i **PBP-së**, si një obligim i detyrueshëm për eksportuesit që përdorin licencat globale, përforcon rolin e programit të përputhshmërisë në adresimin e kontrollit të eksportit dhe sanksioneve në lidhje me çdo nivel maturimi të kontrollit të eksportit të një vendi të tretë.

Të përgjithshme - Parimi i klauzolës “së përgjithshme” për arsye të sigurisë publike, duke përfshirë parandalimin e akteve të terrorizmit, ose për konsiderata të të drejtave të njeriut, mund të kategorizohet njëkohësisht si i transpozueshëm dhe frymëzues për vendet e treta për shkak të, ndër të tjera, rëndësisë së tij të madhe lidhur me rrezikun e konsiderueshëm të terrorizmit të viteve të fundit. Bashkëpunimi ndërinstytucional dhe ndërshtetëror i ndërlidhur me krijimin e listave kombëtare të kontrollit jashtë fushëveprimit të Shtojcës I është një parim frymëzues, i cili mund të jetë edhe i transpozueshëm për shtetet që janë anëtare të të njëjtit bashkim doganor. Përveç kësaj, duke pasur parasysh se lista e kontrollit të BE-së me përdorim të dyfishtë është një “listë kontrolli të referimit” për shumë vende, qasja në informacionin e përditësuar të konsoliduar mbi artikujt e kontrolluar në kuadër të kornizës së përgjithshme të BE-së do të rrisë nivelin ndërkombëtar të sigurisë.

Autorizimet - Rregullorja e Këshillit (KE) Nr. 428/2009, neni 9 liston autorizime të ndryshme. Neni 12 i Riformulimit ka plotësuar dhe përmirësuar nenin 9 të mëparshëm me dy dispozita shtesë mbi autorizimet për projekte të mëdha dhe kërkesat e PBP-së, të paraqitura më sipër. Së bashku me disa ndryshime të kërkuara, ky nen mund të konsiderohet i transpozueshëm për vendet e treta. Neni 12 liston lloje të ndryshme autorizimesh si dhe i referohet licencimit elektronik. Të dy elementët mund të mos jenë plotësisht dhe drejtpërdrejt të zbatueshëm për

vendet e treta. Megjithatë, elementët siç janë deklarata e përdorimit përfundimtar për licencat individuale, parakushti i PBP-së për aplikimet për licenca globale dhe kompetenca e autoritetit për licencim mund të konsiderohen blloqe ndërtimi për rregulloret e kontrollit të eksportit të vendeve të treta.

Procedurat doganore - Neni 21 i Rregullores së BE-së për Përdorim të Dyfishtë³³ ruan rolin e zyrës doganore të shteteve anëtare të BE-së, veçanërisht të drejtën e tyre për të pezulluar procesin e eksportit nga territori i tyre ose për të parandaluar që artikujt me përdorim të dyfishtë që mbulohen ose nuk mbulohen nga një autorizim i vlefshëm për eksport të largohen nga bashkimi doganor nëpërmjet territorit të tyre në rastet e përmendura në nenin 21.3. Në Rregulloren (KE) 428/2009, “procedurat doganore” veç ishin përfshira në nenin 16. Ndërsa nocioni i “procedurave doganore” mbeti i pandryshuar, mandati i doganës është zgjeruar si pasojë e zgjerimit të fushëveprimit të Riformulimit, për shkak, ndër të tjera, të dispozitave për klauzolat e reja të përgjithshme ose për harmonizimin e listave kombëtare të kontrollit. Kjo dispozitë është e transpozueshme për vendet e treta – veçanërisht për shtetet që janë anëtarë të territoreve doganore dhe/ose ekonomike të unifikuara – varësisht nga niveli i zhvillimit të elementeve të kontrollit të eksportit si listat e kontrollit, çështjet e përgjithshme dhe autoritetet. Përfshirja e një klauzole të tillë në sistemin e kontrollit të eksportit mund të jetë e dyfishtë. Ajo ka ndikim pozitiv në aspektin e sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare, parandalimin e akteve të terrorizmit, ngritjen e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Kjo ndikon negativisht në aspektin e ndikimit tek subjektet afariste për shkak të vonesave në dorëzim dhe kostove totale të lidhura me to, në rast të pezullimit edhe të gjitha kostot. Për doganat, ka presion të shtuar në operacionet doganore.

Fuqizimi Doganor – Neni 22 i Rregullores së BE-së për përdorim të dyfishtë i referohet të drejtës së shteteve anëtare për të njohur vetëm kompetencën, për të trajtuar formalitetet doganore për eksportin e artikujve me përdorim të dyfishtë, të zyrave doganore të mandatuara për ta bërë këtë.

Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve - Neni 23.2 shtjellon më tej fushat e zbatimit të Rregullores për të cilat konsiderohet i nevojshëm një nivel i rritur i koordinimit dhe shkëmbimit të informacionit. Këto fusha kanë të bëjnë me: të dhënat e licencimit (p.sh. vlera, destinimi dhe lloji i licencës për autorizim); informacionin shtesë në lidhje me kriteret e licencimit ; analizat që mbështesin zbatimin e kontrolleve kombëtare shtesë në përputhje me arsyet e sigurisë publike ; zbatimin e kontrolleve duke përfshirë informacionin mbi auditimet, eksportuesit e përjashtuar dhe aplikimin e ndëshkimeve; të dhënat e përdoruesve fundorë të ndjeshëm dhe rrugëve të përfshira në përpjekjet e dyshimta të prokurimit. Procedurat dhe kërkesat e bashkëpunimit administrativ siç propozohen në kontekstin e BE-së mund të kenë interes të dyfishtë për vendet jo anëtare të BE-së. Nga njëra anë, procedurat e shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve kompetente brenda një vendi janë komponent i rëndësishëm për funksionimin e mirë të çdo sistemi të kontrollit tregtar. Kjo është veçanërisht e vërtetë për zyrtarët e licencimit dhe zyrtarët doganorë të cilët janë përgjegjës për aspekte të veçanta të zbatimit të përgjithshëm të kontrolleve tregtare dhe duhet të koordinojnë nga afër, të mbledhin dhe shkëmbejnë informacione dhe të dhëna mbi parametrat teknikë të një eksporti, treguesit e rrezikut të lidhur me një transaksion dhe dokumentacionin administrativ që do të kontrollohet. Më gjerësisht, licencimi i një eksporti/importi me përdorim të dyfishtë është çështje vërtet ndërsektoriale që përfshin opinionin ose në disa raste miratimin e agjencive dhe ministrive të ndryshme. Në disa vende, korniza ligjore dhe kompetencat që pasojnë janë

mjaft të shpërndara duke e bërë të domosdoshme nevojën për një nivel të përshtatshëm koordinimi. Prandaj, koordinimi ndërinstytucional në nivele të ndryshme dhe sipas nevojave i një sistemi të caktuar administrativ është shumë i rëndësishëm dhe kërkesat specifike të referuara në nenin 23 mund të konsiderohen si të transpozueshme gjerësisht në juridiksionet e vendeve të treta.

Masat e kontrollit - Neni 27 i Rregullores së BE-së për Përdorim të Dyfishtë i referohet detyrimit të eksportuesit dhe ndërmjetësit për të mbajtur regjistra të detajuar ose shënime të aktiviteteve të tyre në dispozicion të autoritetit shtetëror. Ky nen nuk është ndryshuar rrënjësisht nga Riformulimi. Vetëm fushëveprimi i tij është zgjeruar për të përfshirë asistencën teknike. Dispozita mund të konsiderohet si e transpozueshme pasi të gjitha sistemet e kontrollit të eksportit duhet të përfshijnë dispozita për regjistrimin e aktiviteteve dhe të dhëna për t'i mbajtur në dispozicion të autoritetit shtetëror me qëllim të mundësimin të kontrollit të përputhshmërisë së aktiviteteve me rregullat e kontrollit të tregtisë.

Catch-all kontrolli – duhet të përfshihet si procedurë e cila zbatohet në raste të vecanta kur ka dyshime për devijime dhe për qëllime të sigurisë kombëtare /shtetërore. Për ndërmarjen e këtij veprimi duhet të përcaktohen procedurat të cilat duhet ndjekur nga autoriteti licencues me rastin e zbatimit të catch -all kontrollit për mallrat e ndaluara në Dogana.

Procedurat e regjistrimit në regjistër /pajisja me certifikatë – tek procedurat e regjistrimit në regjistër duhet të përfshihen vetëm ato kompani të cilat eksportojnë mallra dhe pajisje ushtarake dhe të largohen nga regjistrimi në regjistër ato kompani që tregtojnë mallra me përdorim të dyfishtë.

Procedurat dhe fushëveprimi i kontrollit – Fushëveprimi i kontrollit për mallra me përdorim të dyfishtë të ketë të përcaktuara dhe të definuara procedurat dhe kriteret ndaras nga ato për mallra dhe pajisje ushtarake.

Detyrimet e persnave që merren me tregti të mallrave strategjike - Afati i ruajtjes së dokumenteve në arhive (record keeping) për kompanitë që tregtojnë mallra me përdorim të dyfishtë të jetë së paku 5 vite ashtu siq përcaktohet me Ligjin në fuqi , ndërsa për kompanitë të cilat eksportojnë mallra ushtarake përcaktohet komfor procedurave të cilat e rregullojnë tregtin e mallrave dhe pajisjeve ushtarake me Traktatin për Tregti të Armëve, minimumi deri në 10 vite.

Definimi i inspektimeve për kompanitë – Inspektimet mund të realizohen në mënyrë *ad-hoc* dhe të rregullt. Inspektimet mund të realizohen para , gjatë dhe pas fazës së licencimit

Rekomandimi 3: Ligji do ta eliminonte kolezionin dhe mos harmonizimin me Ligjin Nr.05/L-022 për Armët, ku do të definohet sakt fushëveprimi i kontrollit të importit të armëve për përdorim civil i cili do mbetet tek DSP/MPB, ndërsa kontrolli i importit dhe eksporteve të mallrave dhe pajisjeve ushtarake sipas përshkrimeve në Listat e mallrave dhe pajisjeve ushtarake të EU-së të adaptuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës , mbetet tek Ligji i ri për kontrollin e tregtisë me mallra startegjike. Me c'rast vie tek eliminimi i duplikimeve të licencave dhe byrokracisë. Eliminimi i barrierave dhe ngarkesave me kosto financiare për Operatorët Ekonomik , kursimi në kohë .

Rekomandimi 4: Sanksionet kundërvajtës me gjobat, Kërkesa për fillimin e procedurës së kundërvajtjes mbi këto gjoba do të paraqitet në gjykatën kompetente konform Ligjit **Nr.05/L-087** për kundërvajtje.

Rekomandimi 5: Harmonizimi me Ligjin Nr.04/L-202 për sistemin e lejeve dhe licencave.Përkufizimi për leje, licenca dhe regjistrim.

Rekomandimi 6: Thjeshtëzimi dhe digjitalizimi i mënyrës së aplikimit për ofrimin e shërbimeve në fushën e tregtisë me mallra startegjike.

Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme

Tabela më poshtë paraqet ndikimet më të rëndësishme që janë identifikuar. Shtojcat 1 deri 4 paraqesin vlerësimin e të gjitha ndikimeve në përputhje me mjetet për identifikimin e ndikimeve ekonomike, shoqërore, mjedisore dhe ndikimeve të të drejtave themelore.Këto mjete janë të listuar në Manualin për Hartimin e Koncept Dokumenteve.Katër shtojcat gjithashtu tregojnë vlerësimin e rëndësisë së ndikimeve të ndryshme dhe nivelin e preferuar të analizës.

Figure: Ndikimet më të rëndësishme të identifikuara për kategorinë e ndikimit

Kategoritë e ndikimeve	Ndikimet përkatëse të identifikuara
Ndikimet ekonomike	Ngritja e qarkullimit dhe kontrollit të tregtisë me mallra startegjike që ndikon në rritje ekonomike dhe buxhetore.
Ndikimet shoqërore	Në informimin e publikut, krim dhe siguri.
Ndikimet mjedisore	Nuk ka ndikime relevante.
Ndikimet në të drejtat themelore	Në të drejtën për administrim të mirë.
Ndikimi gjinor	Nuk ka ndikime relevante.
Ndikimet e barazisë sociale	Nuk ka ndikime relevante.
Ndikimet tek të rinjtë	Nuk ka ndikime relevante.
Ndikimet në ngarkesën administrative	Nuk ka ndikime relevante.

Ndikimi i NVM-ve	Nuk ka ndikime relevante.
------------------	---------------------------

4.1. Ndikimet ekonomike

Ndikimet kryesore ekonomike të identifikuara janë në:

Opsioni 1, që është opsioni *status quo*, nuk do të ndikoj në rritjen apo zvogëlimin e kontrollit. Me këtë opsion do të vazhdojnë problemet e njëjta lidhur me mbrojtjen e Operatorëve ekonomik, madje edhe mund të përkeqësohen për shkak të duplikimit të procedurave licencuese, kostos dhe ngarkesës administrative. Nuk mund të parashikohet më saktësisht se a do të ndikojnë në eliminimin e byrokracisë, eliminimin e kostos për licencë si dhe mos krijimi i mundësive për aplikime online.

Opsioni 2, që ndryshon mënyrën e zbatimit të legjislacionit aktual, gjithashtu nuk do të ketë ndikim të konsiderueshëm në fushën e kontrollit, por do të ndikoj ndjeshëm në mbrojtjen e Operatorëve ekonomik. Kjo ngase do të rritet mbikëqyrja por nuk do të profesionalizohet mbikëqyrja e tregut. Nuk mund të parashihet ndryshimi i nevojshëm efektiv.

Opsionin 3, që parasheh ndryshime legjislative. Kjo për arsye se do të rritet kontrolli i cilësisë me procedurat e përcaktuara. Ky opsion do të siguroj një mbrojtje shumë më efikase të Operatorëve ekonomik lidhur me kontroll të mirëfilltë, eliminimin e barrierave, eliminimi i procedurave byrokratike, harmonizimi me praktikën dhe procedurat konform Legjislacioneve të BE-se, i dhe realizimit të tregtisë edhe në vendet e BE-se konform procedurave të njëjta në krahasim me opsionet 1 dhe 2. Me opsionin 3 vlerësohet se tregtia dhe kontrolli staretgjik do të zhvillohet në mënyrë më të drejtë, ku do të eliminohet byrokracia, ngarkesa administrative dhe financiare për operatorë, e njëkohësisht krijohet mundësia e aplikimeve online.

4.2. Ndikimet shoqërore

Ndikimet shoqërore të identifikuara gjatë analizës janë në: informimin e publikut, dhe ndikimi në eliminimin e krimit dhe ofrimin e sigurisë. Pyetjet kryesore të trajtuara për të vlerësuar këto ndikime kanë qenë:

- A do të informohen më mirë operatorët ekonomik për të drejtat e tyre?
- Sa do të parandalohen dhe luftohen kontrabanda dhe informaliteti në tregtinë me mallra strategjike?
- A do të rriten kapacitetet e zbatimit të ligjit, gjegjësisht verifikimi dhe mbikëqyrja e tregut?

4.2.1. Informimi i publikut

Opsioni 1 nuk ka ndikim në informimin e operatorëve ekonomik. Do të vazhdoj gjendja e njëjtë posaçërisht për operatorët ekonomik, ata nuk do të informohen në mënyrë adekuate për ndryshimet e legjislacionit ndërkombëtar dhe harmonizimit me të.

Opsioni 2, veçanërisht aktivitetet për mbikëqyrjen e shtuar të tregut, do të ndikojnë që informimi i operatorëve ekonomik të jetë dukshëm më i lartë ngase organi i mbikëqyrjes do të kontrolloj më shumë bizneset se a janë duke i zbatuar rregullat e përcaktuara me legjislacionin

aktual. Për informimin e operatoreve ekonomik do të vazhdoj gjendja e njëjtë ngase kjo nuk është ngritur si problematikë gjatë diskutimeve për këtë Koncept Dokument. Kësi lloji të ndikimit do të ketë edhe Opsioni 3, mirëpo ky opsion për dallim nga opsioni 2 parasheh sanksione shtesë për ta. Kjo dhe aktivitetet tjera të parapara për rritjen e cilësisë do të kenë ndikim të konsiderueshëm pozitiv për informimin më të mirë të operatorëve ekonomik.

4.2.2. Krimi dhe siguria

Opsioni 1 nuk do ti parandaloj dhe luftoj informalitetin dhe dukuritë tjera të ndaluara me ligj në këtë fushë. Do të vazhdohet me kapacitetet e njëjta për zbatimin e ligjit që nuk sigurojnë në mënyrë adekuate kontrollin e mirëfilltë.

Opsioni 2 nuk ka ndikim evident pozitiv në dukuritë e lartpërmendura dhe në rritjen e cilësisë, meqë do të rritet mbikëqyrja dhe do të ketë trajnime shtesë për stafin e përfshirë.

Opsioni 3 ndikon në parandalimin dhe luftimin efikas të këtyre dukurive, pasi që do të shtohen llojet e kontroleve, sanksioneve dhe ato aktuale do të ngritën. Organi mbikëqyrës do të jetë më i profilizuar për fushën e kontrollit të tregtisë me mallra strategjike, që ngrit kapacitetet e zbatimit të ligjit. Gjithashtu në **opsionin 3** parashihet rritja e stafit dhe avancimi në Departament për Kontrollin e Tregtisë me Mallra Strategjike, që mundëson kontrollim me efikas të tregtisë me mallra strategjike ,zbatim të ligjit si dhe funksionalizim të platformës digjitale për aplikim online.

4.2.3. Ndikimi në të drejtat themelore

E drejta themelore që është relevante në këtë fushë, është e drejta për administrim të mirë. Pyetjet që janë vlerësuar nga grupi punues për matjen e ndikimit në këtë të drejtë janë:

- A do të thjeshtohet procedura administrative për bizneset apo do të komplikohet?
- A ndikohet efikasiteti i administratës në marrjen e vendimeve (p.sh. marrja e vendimeve, afatet procedurale)?

Opsioni 1, nuk avancon të drejtën për administrim të mirë për arsye se do të vazhdojnë problemet e njëjta me kolezionin e kompetencave për marrjen e vendimit. Gjithashtu afatet procedurale që janë do të vazhdojnë dhe në këtë mënyrë nuk do të sigurohet mbrojtja e nevojshme ligjore e palës. Ky ndikim negativ do të vazhdoj edhe me **Opsionin 2**, ngase kjo çështje mund të zgjidhet vetëm me ndryshime ligjore. Në këtë drejtim, **Opsioni 3** që parasheh procedura dhe kompetenca të qarta si dhe përputhshmëri të afateve ligjore me LPPA, rrisin konsiderueshëm gjasat që e drejta për administrim të mirë do të sigurohet në mënyrë adekuate për palën. Çështja e informimit të bizneseve është trajtuar më lartë, në pjesën e ndikimeve shoqërore.

Kapitulli 4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave

Grupi Punues për hartimin e koncept dokumenti në strukturën e tij përbërëse është përfaqësuar me zyrtarë kompetent që kanë mundësuar qasjen dhe sigurimin e informacionit teknik të nevojshme për të punuar të gjithë anëtarët e grupit punues në koncept dokument. Grupi punues është udhëhequr nga drejtorja e DKTMS, duke mundësuar kështu sigurimin e informacionit primar teknik të nevojshëm për të hartuar koncept dokumentin si dhe analizuar ligjin në fuqi. Këto informata i kanë ndihmuar të gjithë anëtarëve të grupit punues të identifikojnë më mirë

shkaqet dhe efektet në përcaktimin e problemit kryesor. Gjithashtu, në përbërje të grupit punues ka qenë edhe përfaqësues të Sekretariatit Koordinues të Qeverisë, Departamenti Ligjor/ZKM, Departamenti për Integritet Europian, Departamentit Ligjor, Departamentit të Financave, Doganave të Kosovës, Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Disaporë dhe Ministria e Financave, Punëve dhe Transfereve duke mundësuar kështu një kompozicion të përshtatshëm dhe të gjerë të grupit punues për të siguruar informata esenciale për të hartuar këtë dokument sipas udhëzuesit dhe doracakut për hartimin e koncept dokumenteve. Gjithashtu, koncept dokumenti i është nënshtruar të gjitha procedurave të parapara me udhëzues për konsultim dhe diskutim publik duke mundësuar mbledhjen e informacioneve të nevojshme edhe nga palët e interesit. Gjatë hartimit të koncept dokumentit nuk ka pasur raste të cilat kanë paraqitur sfida në mbledhjen e informacionit apo raste të cilat kanë cenuar ecurinë e punës si pasojë e mungesës së informacionit esencial.

Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi

Grupi Punues është angazhuar qysh në fillim të hartimit të Koncept Dokumentit, të komunikojë me palët e mëposhtme dhe t'i nxisë ato që të kontribuojnë në përkufizimin e problemit, vlerësimin e ndikimeve dhe ofrimin e opsioneve për adresimin e problemit.

Procesi i konsultimit ka synuar përfshirjen e palëve të interesuara në përkufizimin e problemit, vlerësimin e ndikimeve dhe ofrimin e opsioneve për adresimin e problemit.

Grupi punues ka zhvilluar edhe konsultimet paraprake në përputhje me nenin 36 të Rregulloren (QRK) 17/2024 të Punës së Qeverisë, ku gjatë periudhës 13.11.2024 deri më 03.12.2024 kemi pranuar komente nga SKQ/ZKM, komente këto të cilat janë inkorporuar në draft koncept i cili është përcjellur për konsultim publik.

Gjithashtu palët e interesit dhe publiku i gjerë kanë pasur mundësinë që të kontribuojnë në zhvillimin e më tutjeshëm të këtij Koncept Dokumenti, përmes konsultimeve publike në platformën online. Dokumenti ka qenë i hapur për komente gjatë periudhës 20.12.2024 deri më 10.01.2025, megjithatë për afatin kohor prej 15 ditë pune nuk është pranuar asnjë koment.

Grupi punues ka vlersuar rekomandimet dhe ka ardh në përfundim se:

Duke u ndërlidhur me diskutimet e pjesëmarrësve, kryesuesja e grupit informoi të pranishmit se si është e rregulluar kjo fushë në disa shtete të Bashkimit Evropian dhe bëri krahasimin e nevojshëm me situatën në Republikën e Kosovës. Gjithashtu ajo i informoi pjesëmarrësit për procesin e hartimit të koncept dokumentit, rolin dhe rëndësinë që ka ky dokument në hartimin e ligjit të ri si dhe procedurat që do të ndiqen, duke përfshirë konsultimet paraprake dhe konsultimet publike. Pjesëmarrësit u inkurajuan që të kontribuojnë gjatë hartimit të Koncept Dokumentit me komente e rekomandime plotësuese. Pas përfundimit të takimit ndërministror, grupi punues nuk ka pranuar komente shtesë.

Figura 7: Përmbledhje e aktiviteteve të komunikimit dhe konsultimit të kryera për një koncept dokument

Procesi i konsultimit ka synuar përfshirjen e palëve të interesuara në përkufizimin e problemit, vlerësimin e ndikimeve dhe ofrimin e opsioneve për adresimin e problemit.

Qëlli mi kryesor	Grupi i synuar	Aktiviteti	Komunikimi/njoftimi	Afati Kohor	Personi përgjegjës
Takimi publik hapur për të gjithë palët e interesuara	Të gjitha palët e interesuara (shoqatat e shpeditoreve)	Takimi publik	Përmes emailit, telefonit, dhe njoftimit publik në web-faqe të MINT		Kryesuesja e Grupit Punues
					Kryesuesja e Grupit Punues
Konsultimi me institucionet publike	Institucionet publike	Konsultimi paraprak	Përmes emailit		Grupi Punues në bashkëpunim me Divizionin e Komunikimit në MINTI

Konsultimi publik me shkri m	Të gjitha palët e interesu ara	Publi kimi i konsu ltimit në portal in për konsu ltim publi k	Përmes e-mail dhe platformës		Grupi Punues në bashkëpunim me Divizionin e Komunikimit në MINTI
------------------------------	--------------------------------	---	------------------------------	--	--

Aktivitetet e komunikimit që do të pasojnë pas miratimit të koncept dokumentit do të jenë:

- a) **Fletëpalosjes digjitale**, e cila do të përmbajë të dhëna informuese dhe të risive në fushën e kontrollit të tregtisë me mallra strategjike të cilat do të prezantohet në platformat elektronike të MINTI,
- b) **Organizimi i konferencës vetëdijesuese** për palët e interesit / outreach industry e paraparë edhe me legjislacion të kontrollit staretgjik e po ashtu e paraparë edhe me plan të punës.

Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve

Siç është cekur më lartë, grupi punues ka trajtuar gjithsej tri opsione për adresimin e problemit: Opsioni 1 (status quo), Opsioni 2 (ndryshimi i mënyrës së zbatimit dhe ekzekutimit) dhe Opsioni 3 (hartimi i Ligjit të ri).

Opsioni i parë (1) dhe opsioni i dytë (2) nuk do të kenë ndikime pozitive në adresimin e problemit kryesor të identifikuar në këtë Koncept Dokument. Përkundrazi, mund të kenë ndikim të kundërt në problemin e identifikuar duke rritur peshën negative të efekteve në avancimin e shërbimeve, mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve dhe në mbrojtje të konkurrencës. Në anën tjetër, opsioni i tretë (3) do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e infrastrukturës ligjore e cila rregullon dhe mbron dhe konkurrencën dhe avancon tregtine me mallra strategjike në Republikën e Kosovës. Problemi që është identifikuar në këtë Koncept Dokument “Nevoja për avancimin e tregtisë me mallra strateegjike në përputhje me zhvillimet e tregut dhe praktikat më të mira ndërkombëtare” është kryesisht i ndërlidhur me bazën aktuale ligjore. Opsioni i tretë (3) do të sjell ndryshime substanciale në politikën ekzistuese, ku përmes hartimit të ligjit të ri për tregtinë me mallra strategjike synohet përmirësimi i kornizës ligjore dhe zbatimi efektiv i ligjit.

Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme

Figura: Plani i zbatimit për Opsionin 1

Qëllimi i Politikës	Status Quo pa asnjë ndryshim	Shifra e kostos së pritur
---------------------	------------------------------	---------------------------

Objektivi Strategjik	Zbatimi i Ligjit në fuqi									
Ndërtimi i një mjedisi biznesi të drejtë, të adaptueshëm dhe konkurrues										
Objektivi specifik 1: 1.1.3.Masa strategjike-	Produkti 1.1:Zbatimi i aktiviteve aktuale Zbatimi i Ligjit aktual	Rritja e mbikëqyrjes se tregtis me mallra strategjike								
		Aktivitetet	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni / Departamenti Përgjegjës		
		1.1.1: Angazhimi	x	x	x	x	x	DKTMS		
Objektivi Specifik 1: Ngritja e kapaciteteve	Produkti 1.2	Rekrutimi i zyrtareve dhe trajnime								
		Aktivitetet	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni / Departamenti Përgjegjës		
		2.1.2: Rekrutim i stafit të ri me profile teknike të reja	x	x	x	x	x	DKTMS		
		2.1.2: Furnizimi me pajisje dhe inventarë për stafin e rekrutuar	x	x	x	x	x			

Figura: Plani i zbatimit për Opsionin 2

Qëllimi i Politikës		Shifra e kostos së pritur
Objektivi Strategjik		

Aktivitetet	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Institucioni/Departamenti Përgjegjës
Aktiviteti 1.1.1 Rritja e numrit të stafit dhe trajnime t	x	x			DKTMS/ MINTI-Dept Ligjor
1.1.2 Informimi i operatorëve			x		DKTMS / Dept Ligjor/GP

Opsioni 3 është konsideruar nga grupi punues si opsioni më i përshtatshëm që do të shkonte përtej përmirësimit të zbatimit dhe ekzekutimit të kornizës aktuale ligjore, pra është opsioni që do të eliminonte paqartësitë dhe mangësitë e ligjit aktual i cili është në fuqi.

Figura: Plani i zbatimit për Opsionin 3

Qëllimi i politikës	Përmirësimi i kornizës ligjore e fushen e kontrollit të tregtisë me mallra							Shifra e kostos së pritur
Objektivi strategjik	Ndërtimi i një mjedisi biznesi të drejtë, të adaptueshëm dhe konkurrues							
	Output, aktivitetet, viti dhe organizata/departamenti përgjegjës							
Objektivi Specifik 1 Hartimi i Legjislacionit primar dhe sekondar, duke përfshirë harmonizimi me	Produkti 1.1 Hartimi i ligjit	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /DKTMS	Kostoja totale €
	Aktiviteti 1.1.1 Themelimi i grupit punues dhe hartimi i ligjit	x						5,000.00

Legjislacioni n perkatese ne fushen e kontrollit te tregtise me mallra strategjike		Konsultimet ndërministror e	x						500.00	
		1.1.2.Konsult imi publik përmes platformës përkatëse online	x						200.00	
		1.1.3.Përgatit ja e materialeve për miratim në Qeveri	x						100.00	
		1.1.4 Informimi i palëve të interesit lidhur me ligjin	x	x					3,000.00	
	1.2 Hartimi i akteve nënligjor e qe derivojne nga Ligji tregti me mallra strategjik e	1.2.1.Themel imi i grupit punues dhe hartimi i akteve nënligjore			x	x				4,000.00
		1.2.2 .Konsultimet ndërministror e			x	x				1,000.00
		1.2.3.Konsult imi publik përmes platformës përkatëse online			x	x				100.00
		1.2.4.Informi mi i palëve të interesit			x	x				3,500.00
	Objektivi Specifik 2 Thjeshtëzimi dhe digjitalizimi i mënyrës së aplikimit për ofrimin e shërbimeve në fushën e tregtisë me mallra startegjike	2.1 Funksion alizimi i databaze s ,platform es digjitale .		Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	INSTIT UCIONI / DKTMS	Kostoja totale €
			Aktiviteti 2.1.1 Funksionalizi mi dhe mirëmbajtja e platëformes digjitale	x	x	x				4,500.00

Objektivi specifik 3 Zhvillimi i fushatës vetë dijesuese dhe informuese	Produkti 3.1 Fushatë informuese/ vetdijesuese		Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	INSTIT UCIONI /DKTMS	Kostoja totale €
		Aktiviteti 3.1.1 Mbajtja e sesioneve informuese me operatorët ekonomik lidhur me shërbimet, shpërndarja e broshurave	x	x				DKTMS	6,000.00
Objektivi specifik 4 Ngritja e kapaciteteve njerëzore		4.1.Trajnimi i stafit ne fushën e tregtise me mallra startegjike		x	x	x			6,000.00

Kapitulli 6.2: Tabela e krahasimit me të tre opsionet

Në këtë Koncept Dokument, siç është cekur edhe më lartë, janë trajtuar gjithsejt tri opsione: 1) opsioni asnjë ndryshim; 2) opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit dhe ; 3) opsioni për hartimin e Projektligjit të ri për kontrollin e tregtisë me mallra strategjike.

Grupi punues ka përdorur analizën e kosto-efektivitetit për krahasimin e opsioneve. Pra, kriteri krahasues është kosto më e vogël, brenda buxhetit të caktuar, në raport me efektin më të madh për arritjen e objektivave të Koncept Dokumentit. Objektivat, siç janë cekur në Kapitullin 2, janë:

- Zhvillimi i mëtejshëm i kontrollit të tregtisë me mallra strategjike ,

- Përafrimi i legjislacionit të Kosovës me atë të BE-së në fushën e tregtisë me mallra strategjike,
- Ngritja e kapaciteteve në fushën e tregtisë me mallra strategjike , dhe
- Eliminimi i procedurave byrokratike, lehtësimi i të bërit biznes, mundësia e licencimit përmes procedurave aplikimit online E-licencimi.

Kosto e Opsionit 1 është brenda buxhetit të caktuar. Mirëpo me këtë opsion objektivat e Koncept Dokumentit do të jenë të pa arritshme, ngase do të vazhdojnë problemet e njëjta lidhur me zbatimin e kontrollit të tregtisë me mallra strategjike .

Kosto e Opsionit 2 është jashtë buxhetit të caktuar. Me këtë opsion do të arrihen pothuajse të gjitha objektivat, përveç atij të avancimit të legjislacionit në fushën e kontrollit strategjik në raport me legjislacionin e BE-së. Në anën tjetër, me Opsionin 3 do të arrihej edhe ky objektivi, si dhe ngritja e cilësisë së kontrollit , e vetëdijes dhe mbrojtja e operatorëve ekonomik për tregti të mirëfillt dhe objektivat do të arriheshin në mënyrë më të shpejtë në krahasim me Opsionin 2. Gjithashtu ky opsion ka ndikim buxhetor për 5 vitet e ardhshëm. Sipas vlerësimit ksotoja e këtij opsioni ka ndikim më të vogël në buxhet se sa opsioni 2 (Shih Figurën 9 e krahasimit të opsioneve).

Vlerësimi i kostos dhe efektit në arritjen e objektivave është bërë me shenjat (+) që nënkupton ndikimin pozitiv, dhe (-) ndikimin negativ. Në rastet kur janë përdorur më shumë se një shenjë, tregohet se ndikimi do të jetë i nivelit më të lartë dhe objektivat do të arrihen më shpejtë. Përfundimi i grupit punues, bazuar në analizën e kosto-efektivitetit, është se opsioni 3 është më i favorshëm se sa dy opsionet tjera.

Figura 4: Krahasimi i opsioneve

Metoda e krahasimit: Analiza e Kosto-Efektivitetit			
	Opsioni 1: Asnjë ndryshim	Opsioni2: Përmirësimi i zbatimit dhe ekzekutimit	Opsioni3: Projektligji për Kontrollin e tregtisë me mallra strategjike
Zhvillimi i mëtejshëm i kontrollit të tregtisë me mallra strategjike	-		
Përafrimi i legjislacionit të Kosovës me atë të BE-së në fushën e kontrollit të tregtisë me mallra strategjike	-		
Ngritja e kapaciteteve në fushën e kontrollit të tregtisë me mallra strategjike	-		
Ngritja e vetëdijes			
Kostot relevante			

Vlerësimi i ndikimit të pritshëm buxhetor	-		
Përfundimi	Nuk rekomandohet	Nuk rekomandohet	Opsioni i rekomanduar

Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm;

Sipas të gjitha analizave të bëra nga ky Koncept Dokument i vetmi opsion që garanton adresimin e problemeve të identifikuara është hartimi i një ligji të ri (opsioni 3). Shkaqet kryesore që na kanë drejtuar në identifikimin e problemit kryesor janë efektet të cilat krijohen nga dispozita ligjore në fuqi.

Plani i veprimit për zbatimin e opsionit të rekomanduar të këtij Koncept Dokumenti do të reflektohet në Planin e Punës së DKTMS.

Plani për zbatimin e këtij Koncept dokumenti, me kusht që të aprovohet me opsionin e rekomanduar Opsioni 3 është si në vijim;

Figura: Plani i zbatimit të opsionit të preferuar

Veprimi	Afati kohor
1. Miratimi i Koncept Dokumentit në fushën e kontrollit të tregtisë me mallra strategjike	K1 2026
2. Hartimi i Projektligjit në fushën e kontrollit të tregtisë me mallra strategjike	K3 2026
3. Aprovimi i Projektligjit në fushën e kontrollit të tregtisë me mallra strategjike në Qeverinë e Republikës së Kosovës	K3 2026
4. Aprovimi Projektligjit për fushën e kontrollit të tregtisë me mallra strategjike në Kuvendin e Republikës së Kosovës	K4 2026
5. Hyrja në fuqi e Ligjit në fushën e kontrollit të tregtisë me mallra strategjike	K4 2026
6. Zbatimi i Ligjit për fushën e kontrollit të tregtisë me mallra strategjike	2026-2030

7.Vleresimi ex post i ligjit per tregti me mallra startegjike	2030
---	------

Kapitulli 7.1.Dispozitat për Monitorim dhe vlerësim

Plani i veprimit për zbatimin e opsionit të rekomanduar të këtij Koncept Dokumenti do të reflektohet në Planin e Punës së MINTI/DKTMS dhe zbatim i këtij plani do të monitorohet nga menaxhmenti i MINTI,nëpërmjet Departamentit ligjor dhe Departamentit për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave. Gjithashtu, ky Koncept Dokument parasheh që pas pesë viteve nga hyrja në fuqi e Ligjit për kontrollin e tregtis me mallra startegjike të behet vlerësimi ex-post i këtij Ligjit (2030).

Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik

Kategoria e ndikimeve ekonomike	Ndikimi kryesor	A prit et të ndo dhe ky ndikim?		Numri i organiz atave, kompan ive dhe/ose individë ve të prekur	Përfitimi i prits hëm ose kost oja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		P o	J o	I lartë/i ulët	I lartë /i ulët	
Vendet e punës ¹	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?			U	U	
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		X			
	A do të ndikojë në nivelin e pagesës?		X			
	A do të ndikojë në		X			

¹ Kur ndikon në vendet e punës, gjithashtu do të ketë edhe ndikime shoqërore.

	lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës?					
Bërja e biznesit	A do të ndikojë në qasjen në financa për biznes?		X			
	A do të largohen nga tregu produkte të caktuara?		X			
	A do të lejohen në treg produkte të caktuara?		X			
	A do të detyrohen bizneset të mbyllen?		X			
	A do të krijohen biznese të reja?		X			
Ngarkesa administrative	A do të detyrohen bizneset t'i përmbushin detyrimet e dhënjes së informatave të reja?	X		L	U	U
	A janë thjeshtuar detyrimet e dhënjes së informatave për bizneset?	X				
Tregtia	A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të importit?		X			
	A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të eksportit?		X			

Transporti	A do të ketë efekt në mënyrën e transportit të pasagjerëve dhe/ose mallrave?		X			
	A do të ketë ndonjë ndryshim në kohën e nevojshme për të transportuar pasagjerë dhe/ose mallra?		X			
Investimet	A pritët që kompanitë të investojnë në veprimtari të reja?		X			
	A pritët që kompanitë t'i anulojnë ose shtyjnë për më vonë investimet?		X			
	A do të rriten investimet nga diaspora?		X			
	A do të zvogëlohen investimet nga diaspora?		X			
	A do të rriten investimet e huaja direkte?		X			
	A do të zvogëlohen investimet e huaja direkte?		X			

Konkurrenca shmëria	A do të rritet çmimi i biznesit të produkteve, siç është energji elektrik?		X			
	A do të ulet çmimi i inputeve të bizneseve, siç është energji elektrik?		X			
	A ka gjasa që të promovohen inovacioni dhe hulumtimi?		X			
	A ka gjasa që inovacioni dhe hulumtimi të pengohen?		X			
Ndikimi në NVM	A janë kompanitë e prekura kryesisht NVM?	X		L	L	L
Çmimet dhe konkurrenca	A do të rritet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët?	X	X	U	U	U
	A do të zvogëlohet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo		X			

	konsumatorët?					
	A do të rriten çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?		X			
	A do të ulen çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?		X			
Ndikimet ekonomik e rajonale	A do të ndikohet ndonjë sektor i veçantë i biznesit?	X		L	U	U
	A është ky sektor i koncentruar në një rajon të caktuar?		X			
Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik	A do të ndikohet rritja e ardhshme ekonomike?		X			
	A mund të ketë ndonjë efekt në normën e inflacionit?		X			

Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore

Kategoria e ndikimeve shoqërore	Ndikimi kryesor	A pritët ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitim i pritsëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo			
Vendet e punës ²	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?		X			
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		X			
	A ndikohen vendet e punës në një sektor të caktuar të biznesit?		X			
	A do të ketë ndonjë ndikim në nivelin e pagesës?		X			
	A do të ketë ndikim në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës?		X			
Ndiki me shoqërore rajonale	A janë ndikimet shoqërore të përqendruara në një rajon apo qytete të veçanta?		X			
Kushtet e punës	A ndikohen të drejtat e punëtorëve?		X			
	A parashihen apo shfuqizohen		X			

² Kur ndikon në vendet e punës, gjithashtu do të ketë edhe ndikime ekonomike.

	standardet për punën në kushte të rrezikshme?				
	A do të ketë ndikim mbi mënyrën e zhvillimit të dialogut social ndërmjet punonjësve dhe punëdhënësve?		X		
Përfshirja sociale	A do të ketë ndikim mbi varfërinë?		X		
	A ndikohet qasja në skemat e mbrojtjes sociale?		X		
	A do të ndryshojë çmimi i mallrave dhe shërbimeve themelore?		X		
	A do të ketë ndikim në financimin apo organizimin e skemave të mbrojtjes sociale?		X		
Arsimi	A do të ketë ndikim në arsimin fillor?		X		
	A do të ketë ndikim në arsimin e mesëm?		X		
	A do të ketë ndikim në arsimin e lartë?		X		
	A do të ketë ndikim në aftësimin profesional?		X		
	A do të ketë ndikim në arsimimin e punëtorëve dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës?		X		
	A do të ketë ndikim në organizimin apo strukturën e sistemit arsimor?		X		

	A do të ketë ndikim në lirinë akademike dhe vetëqeverisjen?		X			
Kultura	A ndikon opsioni në diversitetin kulturor?		X			
	A ndikon opsioni në financimin e organizatave kulturore?		X			
	A ndikon opsioni në mundësitë për personat që të përfitojnë nga aktivitetet kulturore ose të marrin pjesë në to?		X			
	A ndikon opsioni në ruajtjen e trashëgimisë kulturore?		X			
Qeverisja	A ndikon opsioni në aftësitë e qytetarëve të marrin pjesë në procesin demokratik?		X			
	A trajtohet çdo person në mënyrë të barabartë?	X		L	U	U
	A do të informohet më mirë publiku në lidhje me çështje të caktuara?	X		L	U	L
	A ndikon opsioni në mënyrën se si funksionojnë partitë politike?		X			
	A do të ketë ndonjë ndikim në shoqërinë civile?		X			
Shëndeti dhe siguria publike ³	A do të ketë ndonjë ndikim në jetën e njerëzve, siç është jetëgjatësia apo shkalla e vdekshmërisë?		X			

³ Kur ka ndikim në shëndet publik dhe siguri, atëherë rregullisht ka ndikime mjedisore.

A do të ketë ndikim në cilësinë e ushqimit?		X			
A do të rritet apo zvogëlohet rreziku shëndetësor për shkak të substancave të dëmshme?		X			
A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në nivelet e zhurmës apo cilësinë e ajrit, ujit dhe/ose tokës?		X			
A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në përdorimin e energjisë?		X			
A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në deponimin e mbeturinave?		X			
A do të ketë ndikim në mënyrën e jetesës së njerëzve, siç janë nivelet e interesimit për sport, ndryshimet në ushqyeshmëri, ose ndryshimet në përdorimin e duhanit ose alkoolit?		X			
A ka grupe të veçanta që përballen me rreziqe shumë më të larta se të tjerat (të përcaktuar sipas faktorëve, të tillë si mosha,		X			

	gjinia, aftësia e kufizuar, grup shoqëror apo rajoni)?					
Krimi dhe siguria	A ndikohen gjasat që të kapen kriminelët?		X	L	U	U
	A ndikohet fitimi i mundshëm nga krimi?		X	L	U	U
	A ndikon në nivelet e korrupsionit?		X			
	A ndikohet kapaciteti i zbatimit të ligjit?	X		L	L	L
	A ka ndonjë efekt në të drejtat dhe sigurinë e viktimave të krimit?		X			

Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore

Kategoria e ndikimeve mjedisore	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritur nga hëmbosja e kostojave të ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo			
Klima dhe mjedisi i qëndrueshëm	A do të ketë ndikim në emetimin e gazrave serë (dioksid karboni, metani etj.)?		X			
	A do të ndikohet konsumi i karburanteve?		X			

	A do të ndryshojë shumëllojshmëria e burimeve që përdoren për prodhimin e energjisë?		X			
	A do të ketë ndonjë ndryshim në çmim për produktet miqësore ndaj mjedisit?		X			
	A do të bëhen më pak ndotëse disa aktivitete të caktuara?		X			
Cilësia e ajrit	A do të ketë ndikim në emetimin e ndotësve të ajrit?		X			
Cilësia e ujit	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave të ëmbla?		X			
	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave nëntokësore?		X			
	A ndikon opsioni në burimet e ujit të pijshëm?		X			
Cilësia e tokës dhe shfrytëzimi i tokës	A do të ketë ndikim në cilësinë e tokës (në lidhje me acidifikimin, ndotjen, përdorimin e pesticideve apo herbicideve)?		X			

	A do të ketë ndikim në erozionin e tokës?		X			
	A do të humbet tokë (përmes ndërtimit, etj.)?		X			
	A do të fitohet tokë (përmes dekontaminimit, etj.)?		X			
	A do të ketë ndonjë ndryshim në shfrytëzimin e tokës (p.sh. nga shfrytëzimi pyjor në shfrytëzim bujqësor apo urban)?		X			
Mbeturinat dhe riciklimi	A do të ndryshojë sasia e mbeturinave të gjeneruara?		X			
	A do të ndryshojnë mënyrat në të cilat trajtohen mbeturinat?		X			
	A do të ketë ndikim në mundësitë për riciklimin e mbeturinave?		X			
Përdorimi i burimeve	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve të ripërtëritshme (rezervave të peshkut, hidrocentraleve, energjisë diellore etj.)?		X			

	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve, të cilat nuk janë të ripërtëritshme (ujërat nëntokësore, mineralet, qymyri etj.)?		X			
Shkalla e rreziqeve mjedisore	A do të ketë ndonjë efekt në gjasat për rreziqe, të tilla, si zjarret, shpërthimet apo aksidentet?		X			
	A do të ndikojë në gatishmërinë në rast të fatkeqësive natyrore?		X			
	A ndikohet mbrojtja e shoqërisë nga fatkeqësitë natyrore?		X			
Biodiversiteti, flora dhe fauna	A do të ketë ndikim në speciet e mbrojtura apo të rrezikuara apo në zonat ku ato jetojnë?		X			
	A do të preket madhësia apo lidhjet midis zonave të natyrës?		X			
	A do të ketë ndonjë efekt në numrin e specieve në një zonë të caktuar?		X			

Mirëqenia e kafshëve	A do të ndikohet trajtimi i kafshëve?		X			
	A do të ndikohet shëndeti i kafshëve?		X			
	A do të ndikohet cilësia dhe siguria e ushqimit të kafshëve?		X			

Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore

Kategoria e ndikimit në të drejtat themelore	Ndikimi kryesor	A pritet të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo			
Dinjiteti	A ndikon opsioni në dinjitetin e njerëzve, në të drejtën e tyre për jetë apo në integritetin e një personi?		X			
Liria	A ndikon opsioni në të drejtën e lirisë së individëve?		X			
	A ndikon opsioni në të drejtën e një personi për privatësi?		X			

	A ndikon opsioni në të drejtën për t'u martuar apo krijuar familje?		X			
	A ndikon opsioni në mbrojtjen ligjore, ekonomike ose shoqërore të individëve apo familjes?		X			
	A ndikon opsioni në lirinë e mendimit, ndërgjegjes apo fesë?		X			
	A ndikon opsioni në lirinë e shprehjes?		X			
	A ndikon opsioni në lirinë e tubimit ose asociimit?		X			
Të dhënat personale	A përfshin opsioni përpunimin e të dhënave personale?		X			
	A janë të drejtat e individit për qasje, korrigjim dhe kundërshtim të garantuara?	X		L	U	U
	A është e qartë dhe e mbrojtur mirë mënyra në të cilën përpunohen	X		L	U	U

	të dhënat personale?					
Azili	A ndikon ky opsioni në të drejtën për azil?		X			
Të drejtat pronësore	A do të ndikohen të drejtat e pronësisë?		X			
	A ndikon opsioni në lirinë për të bërë biznes?		X			
Trajtimi i barabartë ⁴	A e mbron opsioni parimin e barazisë para ligjit?	X		L	U	U
	A ka gjasa që grupe të caktuara do të dëmtohen në mënyrë direkte apo indirekte nga diskriminimi (p.sh. ndonjë diskriminim në bazë gjinore, racore, ngjyre, etnie, opinioni politik ose tjetër, moshe ose orientimi seksual)?		X			
	A ndikon opsioni në të drejtat e personave me aftësi të kufizuara?		X			
Të drejtat e fëmijëve	A ndikon opsioni në të		X			

⁴ Barazia gjinore trajtohet në *Vlerësimin e Ndikimit Gjinnor*

	drejtat e fëmijëve?					
Administrimi i mirë	A do të bëhen procedurat administrative më të komplikuar?		X			
	A ndikohet mënyra në të cilën administrata merr vendime (transparenca, afati procedural, e drejta për qasje në një dosje, etj.)?	X		L	L	L
	Për të drejtën penale dhe ndëshkimet e parashikuara: a ndikohen të drejtat e të paditurit?		X			
	A ndikohet qasja në drejtësi?		X			